

**KATEKIZMI I KRISHTERË ORTHODHOKS**

# **PERËNDIA MË KRIJOI ME DASHURI**

**Libër Katekizmi**

**Vëllimi II \* Mësimi 19-36**

**\* \* \***

**Tiranë, 2008**

Copyright © Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë  
Shtypur në shtypshkronjën “Ngjallja”



Ky libër botohet me bekimin e Fortlumturisë së Tij,  
Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe  
të gjithë Shqipërisë, Prof. Dr. Anastasit



# PËRMBAJTJA

## **Kapitulli 6** FISI IM .....7

- 19. Tregimi për gjyshe Naomin ..... 9
- 20. Davidi, biri i Jeseut ..... 15
- 21. Mbreti Solomon, biri i Davidit ..... 21
- 22. Maria viziton kushërirën e saj, Elisabetën ..... 27

## **Kapitulli 7** ANËTARËT E FAMILJES KUJDESEN PËR NJËRI-TJETRIN 33

- 23. Jam krijuar në mënyrë të mrekullueshme ..... 35
- 24. Prindërit kujdesen për fëmijët e tyre ..... 41
- 25. Nënata çojnë fëmijët e tyre tek Jisui ..... 47
- 26. Josifi ndihmon familjen e tij ..... 53

## **Kapitulli 8** TË SHKUARIT MIRË ME ANËTARËT E FAMILJES .....59

- 27. Vëllezërit falin ..... 61
- 28. Vëllai i madh bëhet xheloz ..... 67
- 29. Familja e Perëndisë përfshin çdo njeri ..... 73
- 30. Lidia mirëpret familjen e Perëndisë ..... 79

## **Kapitulli 9** ANËTARËT E FAMILJES BËJNË SHUMË GJËRA SË BASHKU 85

- 31. Paravolia e dy bijve ..... 87
- 32. Jisui adhuron së bashku me prindërit e tij ..... 93
- 33. Jisui dhe nëna e tij shkojnë në një dasmë ..... 99
- 34. Marta dhe Maria presin Jisuin në shtëpi ..... 105

## **Kapitulli 10** FAMILJA E PERËNDISË KREMTON..... 111

- 35. Festa e Ngjalljes së Jisu Krishtit ..... 113
- 36. Festa e Ngjitjes në qiell ..... 119
- LUTJE PËR FËMIJËT ..... 125



# Fisi im

Përveç nënës, babait, vëllezërve dhe motrave kam edhe shumë anëtarë të tjerë në familje. Gjyshërit, stërgjyshërit, hallat, tezet, xhaxhallarët, dajat dhe kushërinjtë e mi përbëjnë fisin tim.





### *Për prindërit*

Për fëmijën e vogël përjetimi i familjes është shumë i rëndësishëm, për sa i përket një zhvillimi të shëndetshëm të identitetit.

- ☺ Tregimi për Naomin dhe Ruthin u paraqet atyre marrëdhënien me gjyshërit.
- ☺ Stërgjyshërit janë fokusi i mësimi mbi Davidin, birin e Jeseut.
- ☺ Tregimi i Mbretit Solomon paraqet një mundësi për t'u fokusuar mbi urtësinë e anëtarëve më të mëdhenj të familjes së tyre, nga të cilët mund të mësojnë shumë.
- ☺ Në fund, tregimi i vizitës që iu bë Marisë nga kushërirat e saj Elisabeta, vë në dukje marrëdhënien e veçantë midis kushërinjve.



Mësimi 19

## Tregimi për gjyshe Naomin

**“Nipërit dhe mbesat janë kurora e gjyshërve”**

Bazuar te Fjalët e Urta 17: 6



Zbuloni

Nënë dhe babanë e mamasë sime i kam gjyshër. Edhe nënën dhe babanë e babait tim gjyshër i kam.



**gjysh**

**gjyshe**



Nënë e babit e kam \_\_\_\_\_. Ajo e ka emrin \_\_\_\_\_

Babanë e babit e kam \_\_\_\_\_. Ai e ka emrin \_\_\_\_\_

Nënë e mamasë e kam \_\_\_\_\_. Ajo e ka emrin \_\_\_\_\_

Babanë e mamasë e kam \_\_\_\_\_. Ai e ka emrin \_\_\_\_\_

Gjyshërit kënaqen kur thonë tregime. Këtu kam pikturuar një tregim që dëgjova nga gj \_\_\_\_\_.

Në tregimin tonë, gjeni se gjyshja e kujt është Naomi.



## Shkrimi i Shenjtë

### Gjyshe Naomi i thotë një tregim Obedit

Mbështetur te Libri i Ruthit


Ndiqni tregimin ndërkohë që mësuesi e lexon. Sa herë që të shihni ndonjë figurë thoni emrin e personit të cilin përfaqëson.



Ruthi



Naomi


- “**Obed**, biri im, eja të të puth” - tha . - Sot mbushe gjashtë vjeç!”
- “Gjyshe, a do të më thuash ndonjë tregim sot?”
- “Patjetër biri im. Do të them një, të cilin dua ta them shpesh. Ai bën fjalë



për mënyrën sesi u takuan prindërit e tu.”


Obedi u ul pranë, në mënyrë që të dëgjonte tregimin që aq shumë deshte ta dëgjonte.

- “Për shumë vjet familja ime jetonte e lumtur në Betlehem. Më vonë, një pranverë shiu pushoi së rëni. Fushat u thanë, drithërat nuk rriteshin. Familja jonë u largua nga Izraeli dhe shkoi të jetonte me moabitët miqësorë.”

“Për sa kohë?” - pyeti Obedi. - “Për plot 10 vjet”, - tha .


- “Çfarë ndodhi më pas?” - kërkoi Obedi të

mësonte. -“Im shoq dhe bijtë e mi vdiqën. Vendosa të kthehesha në Betlehem ku shiu kishte filluar përsëri të binte”, - tha ajo.

- “Kisha mbetur me gruan e djalit tim, Mahlonit.  e kishte emrin dhe ishte moabite. Ne e donim shumë atë. Ruthi tha: - “Nënë, nuk duhet të ndahemi kurrë nga njëra-tjetra. Ti e di që të dua. Ku të shkosh ti do të vij dhe unë, Perëndia yt do të jetë Perëndia im, populli yt do të jetë populli im.”





Ne arritëm në Betlehem gjatë sezonit të korrjes së elbit. Ishte një i pasur që quhej Boaz. Ai tregohej i mirë me Ruthin. Ai e linte të mblidhte kallinjtë e rënë të elbit në arat e tij.

Një ditë i dëgjova të bisedonin.  tha: “Unë jam e huaj në këtë vend. Përse silleni kaq mirë me mua?”

“Sillem mirë”, - tha Boazi, - “sepse më ke fituar zemrën me mirësinë dhe punën që bën.”

Sa u lumturua ajo kur dëgjoi Boazin të thoshte ato fjalë! Faqet iu bënë të kuqe si drita e rrezeve të diellit.

Një mbrëmje të bukur vjeshte,  dhe Boazi i mirë u martuan.

Boazi,  dhe unë jetonim të lumtur së bashku. Perëndia na e bekoi punën dhe na e shtoi gëzimin kur pak më vonë linde ti, Obed!

Fqinjët e mi e falënderuan Perëndinë që më bekoi me një djalë, një vajzë dhe tani me një nip, me ty.




Duke përdorur kokrra elbi shkruani emrin e nipit të Naomit. Gjeni emrin e tij në fillim të tregimit.



## Gjeni gjyshërit në pemën familjare

Mësuam më parë gjatë këtij viti për një tjetër çift gjyshërish. Ata janë Joakimi dhe Ana, prindërit e Virgjëreshës Mari. A mund të thoni se gjyshërit e kujt do të ishin ata? Zgjidhni emrat e tyre në pemë.

Ngyrosni kutinë e emrit të nipit/mbesës me të verdhë dhe kutitë e emrave të gjyshërve me të gjelbër.



Çdo vit në festën e Pashkës, Joakimi dhe Ana hanin një vakt të veçantë. Gjatë këtij vakti, Joakimi i thoshte një tregim të veçantë Marisë, vajzës së tyre të vogël. Ai i tregonte Marisë sesi Perëndia me dashuri kishte shpëtuar popullin e vet, Izraelin nga rreziku dhe i kishte çuar në tokën e tyre. Maria e kujtonte këtë tregim mbi dashurinë e Perëndisë dhe ndjehej shumë e lumtur.

Jeta në Kishë

## Shën Kozmai thotë tregime



Shën Kozmai nga Etolia ishte një murg që e donte shumë Perëndinë dhe bënte një jetë të qetë në manastirin e tij. Një ditë ai filloi të shqetësohej për njerëzit të cilët nuk dinin shumë rreth Perëndisë. Ai shkante nga një fshat në tjetrin duke i treguar njerëzve se Perëndia është dashuri dhe se Ai dërgoi Birin e Tij, Jisu Krishtin, për të na shpëtuar ne. Sa herë që Shën Kozmai shkante në një fshat të ri, ai u kërkonte njerëzve të atij vendi të vendosnin në mes të fshatit një kryq. Ai nuk

ishte shumë i gjatë, kështu që qëndronte mbi një stol, pranë kryqit dhe u tregonte njerëzve histori nga Bibla, u tregonte se “Perëndia është dashuri”, si dhe dëshironte për ne që “të duam njëri-tjetrin”. Shën Kozmai ka ardhur edhe në disa fshatra e qytete të vendit tonë, Shqipërisë, duke ndihmuar shumë njerëz të mësonin për Perëndinë.

Si mendoni, për çfarë kishte më shumë nevojë Shën Kozmai në këtë udhëtim? Shihni figurat dhe fjalët. Qarkoni dy nga ato për të cilat ai kishte patjetër nevojë.

### Fjalë Besimi

#### SHENJTOR

Njeri që e do Perëndinë dhe sillet me njerëzit e tjerë me dashuri.



kryq



bangë



kujtoj



dëgjoj

## Ne kujtojmë shenjtorët

Maria e vogël dëgjonte tregime të veçanta të dashurisë së Perëndisë gjatë vaktit të Pashkës. Ne festojmë vaktin e veçantë të Jisuit kur kremtojmë Liturgjinë Hyjnore. Gjithashtu, ne kujtojmë shenjtorët të cilët na treguan dashurinë e Perëndisë. Dhjakoni na kërkon të kujtojmë shenjtorët. Ne i kërkojmë Perëndisë t'i kujtojë ata. Ne i përgjigjemi lutjeve të dhjakonit duke kënduar:

MËSHIRO O ZOT

## KËNDI FAMILJAR

Mësimi i sotëm është i pari i katër mësimeve të cilët fokusohen mbi fisin, gjyshërit, tezet, hallat, xhaxhallarët, dajat dhe kushërinjtë. Me anë të tregimit për Ruthin dhe Naomin fëmija juaj pati mundësinë t'i kushtojë vëmendje marrëdhënies së veçantë që ekziston midis gjyshërve dhe nipërve e mbesave. Mësimi ynë paraqiti gjyshe Naomin e cila kujton ngjarjet e veçanta në jetën e saj, ndërsa ia ritregon ato Obedit, nipit të saj, tregimin sesi u takuan prindërit e tij. Nëpërmjet këtij rrëfimi, ajo ruan një element shumë të rëndësishëm në shoqërinë e hershme, traditën gojore historike dhe rëndësinë e saj në forcimin e lidhjeve familjare.

Fëmijët u prezantuan me gjyshërit nga mamaja të Jisuit, Joakimin dhe Anën, të cilët morën pjesë në traditën izraelite të rrëfimit të tregimit të Eksodit, vajzës së tyre Marisë, gjatë vaktit të veçantë çdo Pashkë.

Rrëfimi i tregimeve dhe kujtimi lidhej më tej me tregimin për jetën e Shën Kozmait dhe kujtimin të shenjtorëve në Liturgjinë Hyjnore.

Ja disa gjëra të cilat mund t'i bëni së bashku për të ndihmuar fëmijën tuaj të rritet në vlerësimin e gjyshërve të tij/saj dhe mësimin për të kujtuar ata që na ushqejnë shpirtërisht, shenjtorët e kishës.

**1. Kohë për tregim:** Kaloni një mbrëmje kujtimi me familjen tuaj. Secili nga ju le të tregojë një kujtim për një nga gjyshërit. Fëmijët mund të shohin fotografitë e familjes apo të bëjnë vizatime të asaj që kujtojnë nga përjetimi i tyre me gjyshërit.

**2. Bëni një pemë familjare:** Shkruani emrat e gjyshërve të familjes, gjyshërve tuaj dhe gjyshërve të fëmijëve tuaj, në fleta letre apo kartoni dhe varini në një degë peme të ngulur në një enë të mbushur me dhe ose rërë.

**3. Praktikoni këndim:** Këndoni "Mëshiro o Zot", përgjigja që këndojmë kundrejt kërkesave që dhjakoni thotë në Litaninë e Madhe gjatë Liturgjisë Hyjnore.

**4. Thuajini** fëmijës suaj tregimin për një shenjtor të preferuar apo për shenjtorin, emrin e të cilit mban.

## Mësimi 20

### Davidi, biri i Jeseut

#### *“Fryma e Zotit ishte me Davidin”*

Bazuar te I Samueli 16:13



#### Zbuloni


Babi im ishte shumë i lumtur dhe i gëzuar. Ai na kërkoi të bëheshim gati shpejt. “Do të shkojmë të vizitojmë gjyshin dhe gjyshe.” Motra ime që është vetëm katër vjeç pyeti:

“- Babi, po ti ke gjysh dhe gjyshe?” “- Patjetër zemër. Ata janë babai dhe nëna e babait tim” – tha babi. “- Babi, a janë ata gjithashtu gjyshi dhe gjyshja jonë?”

“Ana, ata janë stërgjyshi dhe stërgjyshja juaj. Ata po presin t’ju takojnë të gjithëve!”



Shkruani emrat që dini. Pyetni prindërit për emrat që nuk dini.



Në tregimin tonë nga Bibla gjeni emrat e stërgjyshit dhe stërgjyshes së Davidit.



# Shkrimi i Shenjtë

## Davidi, biri i Jeseut

Mbështetur te I Samueli 16



**Davidi**



**Samueli**








**Boazi**





**Jeseu**










 u fliste tetë bijve të tij për gjyshin e tyre Obedin, dhe stërgjyshërit e tyre  dhe Ruthin. , djali më i vogël, ndihmonte atin e tij të ruante delet në kodrat e Betlehemit. Asnjë ujk nuk guxonte t'i rrëmbente delet e tij. Çdo ujk që i afrohej kopesë ai e godiste me hoben e tij.  i binte gjithashtu flautit. Delet e tij e njihnin tingullin e flautit të . Ato ndjeheshin të sigurta kur dëgjonin Davidin t'i binte flautit, sepse e dinin që ai ndodhej pranë. Një ditë,


prifti i Perëndisë  shkoi të vizitonte të atin e Davidit, .



Perëndia i tha : “- Vendos vaj në bririn tënd dhe shko tani e gjej djaloshin nga Betlehemi të cilin e kam zgjedhur të bëhet mbret i popullit tim një ditë. Do të të tregoj se cili është ai.”

Pasi takoi disa nga bijtë e Jeseut,  pyeti: “- A ke të tjerë bij?” “- Po,” iu përgjigj . “Djali im i vogël, Davidi ndodhet jashtë duke ruajtur delet.”




“- Dërgo dikë që ta lajmëroj të vijnë”,  
 tha . Lajmëtari e gjeti   
 duke i rënë flautit. Ai i thirri:  ,   
 babai yt do që të vish në shtëpi  
 tani.” Kur  hyri në shtëpi, Zoti i  
 tha  : “- Ky është ai që kam  
 zgjedhur! Merr vajin e shenjtë dhe  
 derdhe mbi kokën e tij. Ai një ditë  
 do të bëhet mbret.”  iu bind  
 Perëndisë.



Fryma e Zotit erdhi dhe qëndroi me  
 Davidin që nga ajo ditë. Kur  
 stërnipi i  ,  u rrit dhe u bë  
 mbret i Izraelit, ai i shërbeu Zotit me shumë zell.

Davidi shumë gjëra i bënte mirë. Ngjyrosni figurat që i tregojnë ato.




## Fjalë Besimi

### BOAZI

Stërgjyshi i  
 mbretit David.


Vendosni një √ mbi emrin e stërgjyshit të Davidit.



## Jeta në Kishë

### Këngë lutjesh nga Davidi

Davidi e donte shumë Zotin. Me muzikën e bukur që bënte ai lavdëronte Perëndinë. Ai shkroi shumë këngë lutjesh për të falënderuar Perëndinë apo për t'i kërkuar ndihmë Atij. Në kishë, ne ende i këndojmë këngët e tij. Ekziston një fjalë e veçantë për lutjet që Mbreti David shkroi. Plotësoni kuadratet që ta gjeni këtë fjalë.



1.



shkronja e parë e emrit **Pjetër**

2.



shkronja e katërt e fjalës **lapsi**

3.



shkronja e dytë e fjalës **bangë**

4.



shkronja e parë e **limon**

5.



shkronja e parë e emrit **Maria**

## Shën Nikolla kujdeset për popullin e Perëndisë



Shën Nikolla, ashtu si Davidi, kujdesej shumë për popullin e tij.

Ai mundësonte që çdo fëmije t'i jepej kujdesi i duhur.

A i ndihmonte prindërit t'i dërgonin fëmijët

e tyre në



Ai u jepte



atyre që kishin uri.

Ai e tregonte



e tij për Perëndinë

me anë të përkujdesjes që tregonte për

popullin e Perëndisë.

Bëni një vizatim që tregon se çfarë do të bënit për t'i treguar dashurinë tuaj Perëndisë.



# Psalm lavdërimi

Mbështetur te Psalmi 47:1

Lexoni së bashku me mësuesin tuaj vargun nga psalmi. Përdorni figurat për të thënë fjalët që mungojnë.



këngë



popuj



duar



thërrisni




*trokisni, o*



;



*Perëndinë me*



*gëzimi.*

## KËNDI FAMILJAR

Mësimi i sotëm është i dyti nga katër mësimet që fokusohen mbi fisin, gjyshërit, tezet/hallat, xhaxhallarët/dajët dhe kushërinjtë. Tregimi nga Shkrimi i Shenjtë paraqet Mbretin David, birin e Jeseut, dhe stërnipin e Boazit të cilin e hasëm në tregimin e mëparshëm. Fëmijët gjashtë dhe shtatë vjeçarë ende nuk e kanë idenë e historisë dhe mund të mos kuptojnë lehtë idenë e stërgjyshërve. Meqënëse kanë patur përvojë me gjyshërit, ne u tregojmë atyre në mënyrë grafike që gjyshërit e prindërve janë stërgjyshërit e tyre. Mësimi synon të theksojë që ekzistojnë shumë anëtarë në një fis.

Në këtë mësim, ua paraqesim Davidin fëmijëve si një mbret të mrekullueshëm, të cilin Perëndia e zgjodhi për popullin e Tij. Davidi përdorte aftësitë e tij si muzikant e bari për të dashur dhe për t'u kujdesur për popullin e tij, si dhe për të shprehur dashurinë për Perëndinë, me anë lavdërimesh. Fëmijët u prezantuan gjithashtu me Shën Nikollën, si një tjetër udhëheqës që kujdesej për popullin e Perëndisë.

Ndërsa, fëmijët rriten në vlerësimin për marrëdhëniet në familjen e tyre, ne përdorim Mbretin David për të paraqitur prejardhjen e tij, duke filluar me Boazin dhe Ruthin, djalin e tyre Obedin, i cili u bë ati i Jeseut, atit të Davidit. Tregimi për Mbretin David hedh githashtu themelet e prejardhjes njerëzore të Jisuit.

Dëgjimi i historisë së familjes krijon dhe forcon identitetin e vetë fëmijës. Së bashku me fëmijën tuaj mund të bëni disa nga sugjerimet e mëposhtme:

1. **Identifikoni** stërgjyshërit e tyre nëpërmjet fotove ose i vizitoni.
2. **Lutuni** së bashku duke përdorur **Psalmi 47:1**. Bëjeni fëmijën tuaj të duartrokasë dhe të thërrasë me gëzim gjatë frazave përkatëse.
3. **Vizatoni**: Vëreni fëmijën tuaj të bëjë një vizatim që tregon se çfarë bënte Shën Nikolla për t'u kujdesur për popullin e tij.

## Mësimi 21

# Mbreti Solomon, biri i Davidit

### *Dëgjoje këshillën dhe prano mësimet.*

Bazuar te Fjalët e Urta 19:20




### Zbuloni

Tani që jeni më të rritur, jeni në gjendje të bëni shumë gjëra vetë. Shkruani dhe vizatoni diçka që mundeni ta bëni vetë.



Ndonjëherë keni nevojë për ndihmë për të bërë diçka të re. Apo mund të keni nevojë të bëni një pyetje për të gjetur një përgjigje. Te kush shkoni për ndihmë? Hiqni një vijë nga secila frazë te figura që zgjidhni.



- \* për të mësuar të ngisni biçikletën \*
- \* për të zgjedhur të bëni mirë \*
- \* për t'ju ndihmuar të mblidhni numra \*
- \* për të mësuar një himn të krishterë \*
- \* për të mësuar të silleni mirë \*



Te kush shkoi Mbreti Solomon për ndihmë? Zbulojeni në tregimin nga Shkrimi i Shenjtë.

## Shkrimi i Shenjtë

### Mbreti Solomon vendos me urtësi

Mbështetur te I Mbretërit 3:3-28



Mbreti David zgjodhi birin e tij Solomonin për të qenë mbreti i ardhshëm. Solomoni e donte shumë Perëndinë.

Një ditë, Perëndia bisedoi me të në një ëndërr. “- Kërko, çfarëdo që dëshiron do të ta jap”, - tha Perëndia.

Solomoni u mendua shumë dhe tha: “- Zot, me mirësinë tënde më ke bërë mbret. Por jam ende i ri dhe kam nevojë për ndihmën tënde. Të lutem, më jep urtësi që të di cila gjë është e drejtë dhe cila e gabuar. Perëndia u kënaq me Solomonin dhe tha: “- Do të të jap shumë urtësi”.

Kur Solomoni u zgjua ai lavdëroi Perëndinë.

Një ditë, dy gra të cilat po ziheshin erdhën për të takuar mbretin Solomon.

Njëra nga gratë tha: “- Madhëria juaj, kjo grua dhe unë jetojmë në të njëjtën shtëpi. Djali i saj foshnjë vdiq një natë dhe ajo vodhi djalin tim foshnjë.”

Gruaja e dytë tha: “- Jo, madhëria juaj, djali që jeton është i imi, i vdekuri është i saj!” Kështu u zunë para mbretit.

Solomoni u mendua dhe tha: “- Më sillni një shpatë.” Kur shërbëtori u kthye me një shpatë në dorë, Solomoni i tha: “- Ndaje fëmijën më dysh. Jepi secilës nënë nga një gjysmë!”

Gruaja e parë, fëmija i së cilës ishte gjallë tha: “- Jo, madhëria juaj! Mos

i bëni keq fëmijës, jepjani gruas tjetër!”

Gruaja tjetër tha: “- Ndajeni më dysh!” Atëherë Solomoni tha: “- Mos e vrisni fëmijën, jepjani gruas së parë. Ajo është nëna e tij.”

Çdokush që ndodhej në dhomë u mrekullua sesa me urtësi vendosi Solomoni se kush ishte nëna e vërtetë. Shumë shpejt, çdokush në Izrael mori vesh se çfarë mbreti të urtë kishin dhe lavdëruan Perëndinë.


*Vendosni numrat  
1, 2, 3, 4, 5, 6 në figura  
për të treguar sesi  
ndodhi historia.*



Solomoni bëhet mbret.



Solomoni lavdëron  
Perëndinë.



Dy gra vijnë të takojnë  
mbretin Solomon.



Mbreti Solomon  
sheh një ëndërr.



Mbreti Solomon zgjedh  
se cila është nëna e  
vërtetë e fëmijës.





Mbreti Solomon jep  
urdhër që fëmija të  
ndahet më dysh.

Jeta në Kishë

## Jisui na jep urtësi

Jisui na mëson të bëhemi të urtë. Ai na ndihmon të bëjmë zgjedhje të mira. Më poshtë keni disa mënyra sjelleje që Ai u tregoi pasuesve të Tij. Duke u ndihmuar nga ngjyrat, shkruani shkronjat që mungojnë. Pastaj lexoni se çfarë mësoi Jisui.






## Burrat dhe gratë e urta që e deshën Perëndinë

Shumë kohë më parë, në tokën e Egjiptit, jetonin burra dhe gra të cilët i luteshin dhe i kërkonin Perëndisë t'i bënte të urtë. Ata donin të bënin çdo gjë që i pëlqente Perëndisë.

Ata jetonin në shkretëtirë, punonin dhe luteshin çdo ditë. Shumë njerëz i vizitonin dhe luteshin së bashku me ta. Njerëzit kërkonin ndihmën e tyre të zgjidhnin të drejtën dhe jo të gabuarën.



A njihni ndonjë në familjen tuaj, në kishën apo qytetin tuaj që mund t'ju ndihmojë të zgjidhni të drejtën dhe jo të gabuarën? Qarkoni zgjedhjet që ata do t'ju ndihmonin të bënit si në situatat më poshtë:

Shoku i Kristit do që ai (Kristi) të vjedhë një karamele.



- Merre karamelen
- Mos vidh.

Shoku i Gabrielit përpiqet të fillojë një zënkë me të.



- Mos u zi.
- Bjeri(qëlloje) me grusht në fytyrë!


### Fjalë Besimi

#### URTËSI

Dija dhe zgjedhja e së drejtës dhe së mirës.

## Fjalët e urta na mësojnë të bëhemi të urtë

Fjalët e urta janë thënie në Bibël që na mësojnë sesi të bëhemi të urtë. Këtu keni një fjalë të urtë për fëmijët.



### KËNDI FAMILJAR

Tregimi mbi ngjitjen e Solomonit në fronin e atit të tij, David, u paraqiti fëmijëve shembullin e urtësisë që gjyshërit e tyre kanë. Solomoni kishte para tij shembullin e atit të tij Davidit, besnikëria e të cilit ndaj Perëndisë dhe jeta e drejtë e frymëzuan t'i kërkonte Perëndisë bekimet e tij. Edhe fëmijët tuaj e kanë përvojën e të shikuarit të ju, prindërit e tyre, si njerëz që merrni vendimet e duhura.

Solomoni kërkonte dhe lutej për dhuratën e urtësisë, duke u mbështetur te udhëzimi i dashur i Perëndisë. Fakti që Perëndia e bekoji duke i dhënë urtësi vërtetohet nëpërmjet tregimit të njohur të gjykimit të tij për zënkën mes dy nënave.

Ky mësim i paraqiti mësimet e Jisuit si udhëzime në jetën e përditshme. Fëmijët u prezantuan me shembullin e njerëzve të dashur dhe shpresëtarë që jetuan në shkretëtirën e Egjiptit. Shumë njerëz shkonin tek ata për këshilla mbi mënyrën sesi të jetonin në jetën e përditshme. Fëmijët tuaj gjithashtu kanë të afërm, komshinj dhe shokë të cilët mund t'i udhëzojnë mbi zgjedhjen e së drejtës, jo të gabuarës, dhe që mund t'i mësojnë vlerat e rrënjësura në mësimet e vetë Jisuit.

Si familje, nga sugjerimet e mëposhtme, zgjidhni të zbatoni sa më shumë që të jetë e mundur:

1. Si një kujtues për të jetuar sipas urdhërimeve të Perëndisë, vëreni fëmijën tuaj të bëjë **një vizatim** që tregon  
(a) mirësjellje ndaj të tjerëve, (b) kujdes për nevojtarët, (c) respekt ndaj prindërve.
2. **Shkruani Fjalët e Urta 1:8-9** me shkronja të mëdha në një letër. Vëreni fëmijën tuaj ta zbukurojë dhe ta vendosë në një vend ku mund të shihet lehtë.
3. **Krijoni mundësi** që së bashku me fëmijën tuaj të vizitoni dhe flisni me anëtarë të moshuar dhe të respektuar të familjes apo komunitetit. Kërkoni nga fëmija t'ju tregojë sesi u tregojnë dashurinë e Perëndisë këta njerëz atyre.

## Mësimi 22

### Maria viziton kushërirën e saj Elisabetën

***Me gjithë zemër lavdëroj Zotin,  
dhe jam e gëzuar nga Perëndia, Shpëtimtari im.***

Bazuar te Llukai 1:46-47



### Zbuloni

A keni ndonjë hallë, teze, xhaxha apo dajë? A kanë fëmijë ata? Nëse kanë, atëherë ju keni kushërinj.

Kushërinjtë mund të zbaviten shumë së bashku. Ata mund të luajnë së bashku dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin. Shkruani emrat e disa prej kushërinjve tuaj mbi vijat e ndërprera.

kushëri im



kushëri im

kushërira ime



kushërira ime

Zbuloni në tregimin nga Bibla se çfarë bëri Maria së bashku me kushërirën e saj.

## Shkrimi i Shenjtë

### Maria viziton kushërirën e saj, Elisabetën

Mbështetur te Llukai 1:26-56

Maria jetonte në Nazaret. Një ditë, një engjëll i tha asaj: “- Unë jam Gabrieli, lajmëtar i Perëndisë. **Ti do të lindësh një djalë dhe do ta quash Jisu. Ai do të jetë Mbret,** ashtu si Mbreti David.”


Maria e pyeti: “- Si mund të ndodhë kjo? Unë ende nuk jam martuar.” Engjëlli tha: “- Mos u mërzit. Perëndia do të dërgojë mbi ty Shpirtin e Tij të Shenjtë dhe kështu do të lindësh një djalë. Perëndia mund të bëjë çdo gjë që dëshiron! Ja, kushërirë jote Elisabeta së shpejti do të lindë një djalë edhe pse është shumë e moshuar.”

Maria e besoi engjëllin dhe tha: “- Ja ku jam, unë shërbëtorja e Zotit. **Do të bëj gjithçka që Perëndia kërkon nga unë.**”

Pak ditë më vonë, **Maria vendosi të vizitonte kushërirën e saj.**

Kushërirë Elisabetë dhe burri i saj, Zakaria jetonin në një fshat kodrinor. Maria mori disa nga rrobat e saj dhe u bë gati të shkonte.

Herët në mëngjes, **Maria eci në rrugën tërë dredha dhe me pluhur që të çonte në fshatin kodrinor.** Shpejt, pa shtëpinë e kushërirës. Zemra e saj filloi të rrihte nga gëzimi. Më në fund, arriti të shtëpia dhe trokiti në derë. “- Përshëndetje kushërirë Elisabetë, hape derën, jam Maria.”





**Dera u hap dhe Elisabeta qëndronte krahëhapur e duke buzëqeshur.** Papritmas foshnja e saj filloi të gjuante në barkun e saj. Elisabeta u mbush me Frymë të Shenjtë dhe thërriti me gëzim!

**“- Mari, e bekuar je ndër gratë,** dhe e bekuar është foshnja që është në barkun tënd!  
E bekuar je sepse besove atë që Perëndia të tha se do të ndodhte.”



5

Maria tha:

“- Me gjithë zemër lavdëroj Zotin, dhe jam e gëzuar nga Perëndia, Shpëtimtari im. Që tani e tutje, gjithë njerëzit do të thonë që Perëndia më ka bekuar mua.”

Maria qëndroi me kushërirën e saj, Elisabetën për një kohë të gjatë. Ato të dyja bisedonin për djemtë që do të lindnin. Maria dhe Elisabeta mendoheshin për planet që Perëndia kishte për djemtë e tyre. Pas tre muajsh Maria u kthye në shtëpi.

Jeta në Kishë

## Kushërirë Elisabeta nderon Virgjëreshën Mari

Elisabeta e dinte në zemrën e saj që kushërirë Maria ishte e veçantë. Maria do të bëhej nëna e Jisuit, Birit të Perëndisë.

Elisabeta lavdëronte Perëndinë. Ajo i kërkoi Marisë të qëndronte me familjen e saj për ca kohë. Dy kushërirat kënaqeshin me njëra-tjetrën, ndërsa prisnin që foshnjat e tyre të lindnin.

A ju kujtohet ndonjë rast kur keni vizituar një kushëri? Bëni një vizatim që tregon se çfarë bëtë së bashku. Shkruani disa fjalë që tregojnë sesi lavdëruat Perëndinë së bashku me kushëririn apo kushërirën tuaj. Më pas shkruani disa fjalë të mira që ju apo kushërirë juaj i thatë njëri-tjetrit.

### Lavdërimi i Elisabetës

*Mari, e bekuar je ndër gratë.*

*Fjalë që them për të  
lavdëruar Perëndinë*

---

---

---

*Fjalë të mira që i them  
kushëririt tim*

---

---

---

## Virgjëresha Mari na mëson të lavdërojmë Perëndinë


Virgjëresha Mari tregoj mirënjohëse ndaj Perëndisë që e zgjodhi të bëhej Nëna e Birit të Tij, Jisuit. Ajo këndonte këngë falënderimi dhe këngë lavdërimi.

Këto janë fjalët e këngës së saj të cilat i gjejmë në Ungjillin e Llukait. Këto fjalë i këndojmë çdo ditë në Kishë. Përdorni kodet e ngrave për të plotësuar shkronjat që mungojnë. Do të zbuloni se çfarë tha Virgjëresha Mari për Perëndinë.

### Fjalë Besimi

#### LUTU PËR NE

Ne mund t'i kërkojmë Shën Marisë dhe të gjithë shenjtorëve të lutem për ne.



## Shën Maria lutet për ne

Virgjëresha Mari na do dhe kujdeset për të gjithë ne, ashtu si Biri i saj. Ne mund t'i kërkojmë vazhdimisht shën Marisë të lutet për ne. Në Kishë ne i kërkojmë asaj të lutet për ne, kur këndojmë këtë varg:

*“O Hyjlindëse Mari,  
shpresë e të krishterëve,  
mbrona, ruajna,  
se ti streha jonë e vetme je.”*

### KËNDI FAMILJAR

Në këtë kapitull të parë, i cili fokusohet mbi fisin e fëmijës, tregimi i vizitës së Marisë te kushërira e saj Elisabeta, përmban brenda tij të gjithë elementët që karakterizojnë marrëdhëniet mes kushërinjve. Fëmijët gjashtëvjeçarë mund të kuptojnë që me kushërinjtë ata mund të ndajnë kohën e lojërave, festimet dhe shumë ngjarje të rëndësishme të familjes, të tilla si lindja e një fëmije, martesë apo vizita të thjeshta. Ata gjithashtu mund të kujtojnë raste kur kushërinjtë kanë ndihmuar njëri-tjetrin.

Maria shkon te kushërira pasi merr lajmin nga kryeengjëlli Gabriel se ajo do të bëhet nëna e Birit të Perëndisë. Ajo shkon të rrijë me kushërirën e saj në një kohë shumë të rëndësishme në jetën e saj, për të ndarë gëzimin e saj dhe pritjen e asaj që do të ndodhte. Ndoshta Maria e re kishte nevojë për mbështetje dhe udhëzim nga një kushërirë më e madhe në moshë.

Nëpërmjet këtij mësimi ne hedhim themelet për një marrëdhënie të veçantë të fëmijës me Nënë e Shenjtë të Perëndisë, duke mbjellë farat e nderit që ne i japim asaj në kishë dhe mirëbesimin me të cilin ne kërkojmë për lutjet dhe udhëzimin e saj.

1. **Dëgjoni** me gëzim ndërsa fëmija juaj rithotë tregimin e vizitës së Marisë te Elisabeta.
2. **Pohoni** nderin të cilin Elisabeta i jep Marisë duke e quajtur atë ‘të bekuar ndër gratë’, ashtu si bëri edhe Kryeengjëlli Gabriel, duke shfaqur përkushtimin tuaj ndaj Nënës së Perëndisë. Nëse keni ndonjë ikonë të Lindjes së Jisu Krishtit, vendoseni në një kënd ku familja të jetë në gjendje ta shohë dhe ta nderojë.
3. Së bashku me fëmijën tuaj **lutuni** me anë të lutjes ndërmjetuese *“O Hyjlindëse Mari, shpresë e të krishterëve, mbrona, ruajna, se ti streha jonë e vetme je”*.
4. Kur jeni në kishë, fëmija juaj le të **vërë re** ikonën e Lindjes së Jisu Krishtit që ndodhet në ikonostas.



# Anëtarët e familjes kujdesen për njëri-tjetrin

Anëtarët e familjes sime kujdesen për mua dhe unë kujdesem për ata. Prindërit kujdesen për fëmijët e tyre. Ata kujdesen që fëmijët e tyre të hanë mirë, të jenë të shëndetshëm dhe gjithmonë të sigurt. Ata i çojnë fëmijët e tyre në shkollë. Vëllezërit dhe motrat ndihmojnë dhe kujdesen për njëri-tjetrin.



# Anëtarët e familjes kujdesen për njëri-tjetrin



## *Për prindërit*

Kujdesi që anëtarët e familjes tregojnë për njëri-tjetrin paraqitet si tipar i veçantë nëpërmjet këtyre tregimeve biblike:

- ★ Kujdesi prindëror ndaj fëmijëve paraqitet nëpërmjet tregimeve për ngjalljen e bijës së Jairit dhe shërimit të djalit të centurionit.
- ★ Dëshira prindërore për më të mirën e fëmijëve të tyre shprehet nëpërmjet tregimit të nënave që sjellin për bekim fëmijët e tyre te Jisui.
- ★ Tregimi për Miriamin, Moisiun dhe ai për Josifin që u jep ushqim vëllezërve të tij gjatë zisë së bukës, tregon dashurinë dhe kujdesin e vëllezërve e motrave për njëri-tjetrin.

## Mësimi 23


Jam krijuar në mënyrë të mrekullueshme

***Motra më e madhe e foshnjës qëndronte pranë  
që të shihte se çfarë do t'i ndodhte atij.***

Bazuar te Eksodi 2: 4



### Zbuloni



Nënat kanë nevojë për ndihmë kur kujdesen për fëmijët. Vëllezërit dhe motrat më të mëdha kënaqen kur shohin e luajnë me vëllanë apo motrën e tyre ende foshnjë.

A jeni kujdesur për vëllanë apo motrën tuaj kur ata ishin ende foshnjë? Shihni figurat dhe qarkoni atë e cila tregon veprimin që bëtë për të ndihmuar nënën tuaj.



Në tregimin tonë nga Bibla zbuloni sesi e ndihmoi Miriami vëllanë e saj.



## Shkrimi i Shenjtë

### Miriami shpëton Moisiun foshnjë

Bazuar te Eksodi 1:1 - 2:10

Të afërmit e Josifit jetonin në Egjipt. Ata quheshin hebrenj. Mbreti i Egjiptit nuk i pëlqente hebrenjtë. Ai i detyronte të bënin punë shumë, shumë të rënda.

Më pas, ai urdhëroi që të gjithë foshnjat djem hebre të vriten. Shumë nëna qanin kur ua merrnin foshnjat e tyre djem. Një nënë e mbajti foshnjën e saj djalë të fshehur në shtëpi. Një ditë ajo thuri një shportë me zhuka (kallam kënete) e leu me zift dhe vendosi foshnjën e saj në të.

“-Shkojmë te lumi, Miriam”

- i tha nëna bijës së vet.

Me ngadalë, nëna vendosi shportën mes kallameve që rriteshin pranë lumit.

“- Nënë, do të pres këtu dhe do të ruaj vëllanë tim”  
- p e s h p e r i t i  
Miriami.



Vetëm fare, Miriami qëndronte atje duke parë prapa kallamave vëllanë e saj. Pak më vonë, ajo dëgjoji gra që bisedonin. Ato kishin ardhur të bënin banjë në lumë. “- Duken sikur janë nga pallati i Faraonit,” - mendoi ajo.

Princesha vuri re shportën mbi ujë. Ajo dërgoi një nga shërbëtoret e saj që ta merrte shportën. Princesha hodhi sytë brenda shportës dhe tha: “- Oh, duhet të jetë një nga foshnjat hebre. Sa keq, ai po qan.”

Me yrap Miriami shkoi te princesha dhe i tha “- Të shkoj e të thërras për ju një grua hebre për të rritur foshnjën?” E bija e Faraonit i tha: “- Shko!”

Kur Miriami u kthye së bashku me nënën e saj princesha i tha: “- Merre këtë fëmijë, rrite për mua dhe do të të paguaj.”



**F**oshnja ushqehet dhe rritej nga ditë në ditë. Miriami ishte shumë e lumtur që kishte ndihmuar vëllanë e saj!

Kur foshnja u rrit, nëna e Miriamit e çoi fëmijën në pallat dhe ia dha bijës së Faraonit e ai u bë djali i saj. Ajo i vuri emrin Moisi.

Në tregim gjeni shkronjat e ngjyrosura dhe i shkruani në përputhje me ngjyrën. Do të zbuloni se çfarë bëri Miriami për të ndihmuar vëllanë e saj.

Miria \_\_\_i ndi \_\_\_moi *M*oi \_\_\_iun, \_\_\_ëllanë e saj \_\_\_oshnjë,  
që të shpë\_\_\_onte.

Jeta në Kishë

## Shën Kirili dhe Metodi ndihmojnë njëri-tjetrin


Shën Kirili dhe Shën Metodi, ishin dy vëllezër që e donin shumë Perëndinë dhe dëshironin që t'i tregonin edhe njerëzve të tjerë për Të.

Patriarku Foti u kërkoi të dy vëllezërve që të shkonin në një vend shumë larg shtëpisë së tyre, në Moravi, dhe t'u mësonin njerëzve për Jisu Krishtin.

Njerëzit në atë vend nuk kishin një gjuhë të shkruar ose alfabet.

Të dy vëllezërit duhet të punonin shumë për të krijuar një alfabet për këta njerëz. Kështu ata do të kishin mundësi të flisnin, lexonin dhe shkruanin për Perëndinë, në gjuhën e tyre, ashtu si ne jemi në gjendje të flasim dhe lexojmë për Perëndinë në gjuhën tonë shqipe.

Shën Kirili dhe Metodi ishin shumë të lumtur që kishin ndihmuar njerëzit e Moravisë të kishin gjuhën e tyre dhe të njihnin më tepër Perëndinë!



## Edhe unë mund të ndihmoj

Miriami dhe Shën Kirili e Metodi, janë personazhe, të cilët ndihmuan disa njerëz. Hiqni një vijë nga figura që tregon mënyrën sesi ndihmuan, te emri i tyre.

## Fjalë Besimi

**LUTEM**

Flas me Perëndinë




Shën Kirili  
dhe  
Shën Metodi




Miriami



Zgjidhni figurën që tregon sesi do ta ndihmoni vëllanë apo motrën tuaj. Mund të zgjidhni më shumë se një. Ndiqni udhëzimet e mësuesit.



vëllanë



motrën



## Vëllezërit dhe motrat mund të na mësojnë një lutje

Mësova këtë lutje nga \_\_\_\_\_ im/ime. Këtë lutje e bëj çdo ditë para se të nisem për në shkollë.



### KËNDI FAMILJAR

Ky është i pari nga katër mësimet, që fokusohen mbi mënyrën sesi anëtarët e familjes kujdesen për njëri-tjetrin. Për fëmijët e vegjël familja është një realitet shumë i rëndësishëm. Ajo është vendi të cilin ndjejnë se i përkasin, kanë një ndjenjë sigurie e mbrojtjeje nga ana e prindërve dhe anëtarëve të tjerë të familjes.

Për fëmijët e vegjël, tregimi për foshnjën Moisi paraqet një mundësi që të shohin sesi kujdesen për njëri-tjetrin anëtarët e familjes. Veçanërisht ky tregim i ndihmon fëmijët të identifikojnë dashurinë e Miriamit dhe kujdesin e saj për vëllanë e vet. Nëpërmjet këtij tregimi, shpresojmë që fëmijët të bëhen më të vetëdijshëm dhe vlerësues për dashurinë, kujdesin e shoqërinë e motrave dhe vëllezërve të tyre.

Në këtë mësim, paraqesim gjithashtu edhe shembullin e dy vëllezërve, Shën Kirilit dhe Metodit, të cilët u kujdesën për shumë njerëz. Me ndërhyrjen e tyre, njerëzit e Moravisë jo vetëm u kompletuan me një alfabet dhe gjuhën e tyre, por edhe njohën fuqinë e dashurinë shpëtuese të Jisu Krishtit Zotit tonë.

Në këtë mësim, përfshihet edhe një lutje, të cilën fëmija juaj i vogël mund ta mësojë nga mësuesi apo mësuesja. Mësojuni këtë lutje dhe lutuni me të shpesh, së bashku me fëmijën tuaj.



## Mësimi 24

### Prindërit kujdesen për fëmijët e tyre


***Mos ki frikë, vetëm beso dhe vajza jote do të shërohet.***

Bazuar te Llukai 8:50

#### Zbuloni

Prindërit tanë e tregojnë dashurinë dhe kujdesin e tyre për ne në shumë mënyra.

- Ata kujdesen që ne të hamë mirë.
- Ata na veshin mirë.
- Ata na mësojnë rregulla për të ruajtur shëndetin.
- Ata thërrasin mjekun kur sëmuremi.



Bëni një vizatim që tregon kujdesin e prindërve për ju.

Në tregimet tona nga Bibla, zbuloni sesi një nënë dhe një baba u kujdesën për fëmijët e tyre.



## Shkrimi i Shenjtë

### Dy fëmijë shërohen

Bazuar te Llukai 8:40-56 dhe Joani 4:46-54

Kur po kthehej në Galile, Jisuin po e priste një turmë e madhe njerëzish. Atyre u kishte munguar prania e Jisuit.

Një burrë i quajtur Jair vrapoi te Jisui dhe ra në këmbët e Tij.

“- Përse po bie në gjunjë para Jisuit? Çfarë kërkon prej Tij ky kryetar i rëndësishëm i sinagogës?” - pyesnin disa. Jairi tha: “- Vajzën time të vetme e kam shumë sëmurë. Është vetëm dymbëdhjetë vjeç dhe kam frikë se do të vdesë. Të lutem Jisu, eja në shtëpinë time dhe ndihmoje të shërohet.”

Ndërkohë, të gjithë po shtyheshin për t’iu afruar Jisuit.

Pikërisht në atë moment një njeri erdhi nga shtëpia e Jairit dhe tha:

“- Vajza jote vdiq, mos e shqetëso më Mësuesin.” Por Jisui i tha Jairit:

“- Mos ki frikë, vetëm beso dhe ajo do të shërohet.”

Ata shkuan te shtëpia. Jisui mori vetëm prindërit e fëmijës brenda në dhomë dhe të tjerëve u tha të mos qanin:

“- Ajo nuk ka vdekur, por po fle.” Ata e përqeshën, sepse e dinin që kishte vdekur.

Jisui e kapi për dore fëmijën dhe i tha: “- Çohu vajzë!” Vajza e vogël u ngrit menjëherë. Jisui u tha t’i jepnin vajzës diçka për të ngrënë. Prindërit e saj u çuditën, u lumturuan dhe u treguan mirënjohës!



Në qytetin e Kapernaumit ishte një oficer që e kishte djalin shumë sëmurë. Ai shkoi te Jisui dhe iu lut: “- Të lutem shpejto, eja para se djali të më vdesë.”


Jisui i tha: “- Shko në shtëpi, djali yt do të jetojë.” Ky njeri i besoi fjalët e Jisuit dhe u nis për t’u kthyer në shtëpi. Gjatë rrugës, e takuan shëbëtorët e vet dhe i thanë që djali i tij jetonte. Ati i fëmijës i pyeti: “- Kur filloi të përmirësohet?”

Ata iu përgjigjën: “- Dje, rreth orës një.” Babai i fëmijës e kuptoi që ajo ishte koha kur Jisui i kishte thënë: “- Djali yt do të jetojë.” Ai dhe çdokush në familjen e tij besoi te Jisui.


Jisui tha fjalë të cilat ngushëlluan të dy baballarët. Ngjyrosni enigmën që të zbuloni se çfarë i tha secilit prej tyre.



**Ajo**



**Djali yt**



Jeta në Kishë

## Zoti është bariu im

### Fjalë Besimi

#### **BARI**

Ai që kujdeset për delet.



*Ti, O Zot, je bariu im.*

*Kështu që kurrë nuk do të gjendem në nevojë.*

*Ti më shlodh në fushat me bar të gjelbër.*

*Ti më çon te burimet me ujë të qetë*

*dhe më shuan etjen.*

*Ti je vërtetë një bari i mirë*

*sepse më drejton në rrugë të sigurta.*

*Edhe nëse eci në lugina në errësirë, nuk do të kem frikë.*

*Sepse ti je me mua dhe shkopi yt më bën të ndjehem i sigurt.*

Bazuar te **Psalmi 23**


## Jisui është Bari i mirë

Jisui u tha miqve të tij: “Unë jam bari i mirë.”

Zgjidhni fjalë nga lista për të plotësuar fjalitë. Do të gjeni katër arsye që tregojnë se përse është Jisui, Bari i juaj i mirë.

Jisui më ndihmon të bëj  
zgjedhje të \_\_\_\_\_.

Jisui me ngushëllon kur jam i  
\_\_\_\_\_.




Jisui më ruan *shëndoshë*  
e \_\_\_\_\_.

Jisui më ndihmon të jem  
i \_\_\_\_\_.



## Unë lutem

Mund t'i drejtohem gjithmonë Jisuit për ndihmë, kur jemi mirë dhe kur jemi sëmurë. Lutuni duke përdorur këto fjalë çdo ditë:



## KËNDI FAMILJAR

Dy tregimet e paraqitura në këtë mësim, tregojnë dashurinë e pafund të prindërve, që kërkojnë shërim për fëmijët e tyre, duke mbështetur besimin e tyre te Jisui.

Fëmija juaj tashmë e ka përjetuar dashurinë dhe kujdesin tuaj në shumë mënyra, veçanërisht kur sëmurën. Një fëmijë që digjet nga ethet ndjehet i sigurt dhe ngushëllohet kur prindërit ia lehtësojnë shqetësimin, nëpërmjet kujdesit që tregon mjeku dhe kujdesit të dashur ndaj tyre në shtëpi. Sa e mrekullueshme do të ishte që fëmija juaj të mësojë se i njëjti kujdes që ata përjetojnë nga prindërit, e bën Jairin dhe qeveritarin t'i kërkojnë ndihmë Jisuit. Nëpërmjet këtij tregimi ata mund të mësojnë që prindërit e tyre kanë mbrojtje Jisu Krishtin, ndërsa kujdesen për fëmijët e tyre.

1. Vëreni fëmijën tuaj t'ju **rithotë** të dyja tregimet. Më pas nxirrni Biblën e familjes dhe së bashku me fëmijën tuaj gjeni këto tregime në të, me referenca **Llukai 8:40-56** dhe **Joani 4:46-54**.
2. Kërkoni prej tij t'ju **ilustrojë** një nga dy tregimet.
3. **Kujtoni** një rast kur kanë qenë sëmurë dhe mënyrën sesi jeni kujdesur për ta. Ndoshta priftit iu kërkua të lutej për fëmijën.
4. **Mësoni** së bashku lutjen që mësuam në klasë. Kjo është një lutje që gjendet te një nga shërbesat e përditshme të kishës, e cila ofrohet në enorira gjatë Kreshmës së Pashkës.
5. Bëjeni zakon **të luteni** së bashku me fëmijën tuaj sa herë që sëmuret dhe kërkoni Jisu Krishtin ta shërojë atë.

## Mësimi 25

### Nënat çojnë fëmijët e tyre te Jisui

***I lini fëmijët e vegjël të vijnë te unë dhe mos i pengoni.***

Bazuar te Marku 10:14




### Zbuloni

Prindërit bëjnë shumë gjëra të cilat janë të mira për fëmijët e tyre. Shënoni një √ në çdo figurë që tregon diçka të mirë që prindërit tuaj kanë bërë për ju.



Vizatoni vetë një rast tjetër.



Në tregimin nga Bibla zbuloni se çfarë bënë nënat për fëmijët e tyre.



## Shkrimi i Shenjtë

### Nënat çojnë fëmijët e tyre te Jisui

Bazuar te Mateu 19:13-15 dhe Marku 10:13-16

Një ditë të bukur pranvere, Jisui shkoi në një qytet në anën lindore të lumit Jordan. Kur e morën vesh, të gjithë njerëzit lanë punën e tyre dhe vrapuan te fusha ku gjendej Jisui. Fusha bosh, papritur u mbush me një turmë të madhe njerëzish. Aq shumë e donin njerëzit Jisuin sa që e ndiqnin kudo që shkonte.

Kishte shumë fëmijë dhe foshnja në turmë: “- Nënë, më ngri lart që të shoh Jisuin” - tha Jasoni.

Benjamini dhe Miriami ishin aq të gëzuar sa që kaluan mes turmës dhe shkuan te Jisui. Disa njerëz u zemëruan.

“- Pushoni! I thoni fëmijëve tuaj të pushojnë!” – thërrisnin ata.

Dishepujt u përpoqën të pengonin fëmijët dhe thonin: “- Nëna, kujdesuni për fëmijët tuaj. Mbajini larg Jisuit, pushojini!”

Jisuit nuk i pëlqyen këto fjalë. Ai u kthye nga dishepujt dhe u tha: “- Lërin fëmijët të vijnë te unë! Mos u përpiqni t’i pengoni. Unë i dua ata.” Më pas ai merrte fëmijë shumë të vegjël, i mbante në prehër dhe i bekonte. Ai i lejonte fëmijët të shkonin pranë Tij. Jisui vendoste dorën e Tij mbi çdo fëmijë, fliste me ta dhe i bekonte.





**Imagjinoni.** Vendosni veten tuaj brenda tregimit. Imagjinoni sikur prindërit tuaj po ju çojnë të takoni Jisuin. Ai është duke qëndruar në anë të kodrës së bashku me miqtë e Tij.

**Mendoni.** I bëni vetes këto pyetje:

- A ju sheh Jisui?
- A shkoni te Ai?
- Çfarë i thoni Jisuit?
- Çfarë ju thotë Jisui juve?



Jisui më bekon dhe thotë: “Unë **TË DUA** ty.”







Jeta në Kishë


## Prindërit çojnë fëmijët e tyre në Kishë

Pak kohë pas lindjes suaj, prindërit ju çuan në Kishë. Ata e dinin që djali apo vajza e tyre e vogël kishte nevojë për një bekim nga Jisui. Ju shkuat në krahët e nënës suaj, më pas prifti ju bekoji me shenjën e Kryqit të Shenjtë dhe bëri këtë lutje.

Lexoni lutjen. Përdorni figurat për ndihmë.

*O Zot*  *Krisht, qoftë hiri dhe mëshira jote gjithmonë me*  
*këtë*  *icili, si*  *e sapolindur, ka ardhur për të*  
*të adhuruar në*  *tënde.*

*Mbroje nga çdo e keqe sepse je i mirë ndaj të gjithëve ne!*



### Fjalë Besimi

**HIR**

Dashuria e  
Perëndisë për ne.


## Dita ime e parë në Katekizëm

Sa e mrekullueshme është që prindërit të kanë çuar në katekizëm. Ata duan që ti të mësosh për Jisu Krishtin, Perëndinë tonë dhe të mësoni ta doni gjithnjë e më shumë.

A ju kujtohet hera e parë kur shkuat në katekizëm? Kush ishte mësuesi apo mësuesja juaj? Shkruani emrin e saj/tij mbi këtë vijë.

Mësuesi/mësuesja ime në katekizëm tani është \_\_\_\_\_

Shkruani ose vizatoni diçka që keni mësuar në katekizëm.



## Këndoni së bashku Himnin Trishenjtor

Sa herë që marrim pjesë në Liturgjinë Hyjnore, ne dëgjojmë të këndohet Himni Trishenjtor. Në vazhdim lexoni fjalët e këtij himni.

Lexojini dhe përpquni ta mësoni e këndoni kur merrni pjesë në Liturgjinë Hyjnore.

*Shenjt Perëndi, Shenjt i Fuqishëm,  
Shenjt i Pavdekshëm, mëshirona.*

### KËNDI FAMILJAR

Prindërit kanë eksperiencën e nevojshme për të kuptuar se çfarë është e mirë për fëmijët e tyre. Ata kujdesen që ata të shkojnë në shkollë për të mësuar dhe i mësojnë sesi të bëjnë shumë gjëra. Tregimi për nënat që çojnë fëmijët te Jisui për bekim ilustron këtë tipar prindëror.

Fëmijët e ndjejnë kujdesin ndaj tyre kur shohin iniciativën e këtyre nënave për të kërkuar çka ishte e mirë për fëmijët e tyre. Krahët e hapura të Jisuit dhe bekimi i Tij i sigurojnë fëmijët për pranimin e tyre.

Në këtë mësim fëmijët prezantohen me një lutje, e cila ofrohet kur një foshnjë e sapolindur çohet në kishë për t'u bekuar, veprim i cili njihet me emrin Hyrja në Kishë.

Shumë vite më parë, nëna rrinte në shtrat për të pushuar dyzetë ditë. Gjatë kësaj periudhe, nëna privohej nga pjesëmarrja në kishë, ndërsa anëtarët e tjerë të familjes e çonin foshnjën të pagëzohej. Kisha sugjeroi që fëmija të pagëzohej sa më shpejt të jetë e mundur, pas lindjes. Prandaj, shkuarja në kishë e nënës ndodhte pas pagëzimit dhe ishte hera e parë kur nëna dhe fëmija shkonin së bashku në kishë për të marrë bekim.

Mësimi theksoi gjithashtu regjistrimin e fëmijës në katekizëm, diçka që prindërit zgjedhin për të mirën e fëmijës. Në fund, pason Himni Trishenjtor të cilin ua këshillojmë prindërve t'ua mësojnë fëmijëve të tyre sapo fillojnë të flasin, si pjesë të zhvillimit të tyre fetar.

1. Lexoni pasazhin e shkurtër të **Mateu 19:13-15** apo të **Marku 10:13-16** rreth bekimit të fëmijëve nga Jisui ose kërkojini fëmijës suaj t'ju **rithotë** tregimin që ishte pjesë e këtij mësimi.
2. **Kujtoni** së bashku me fëmijën tuaj ditën kur ai/ajo u çua në kishë si foshnjë për bekim. Mund t'i kërkonte atyre të bëjnë një vizatim mbështetur mbi kujtimin tuaj.
3. **Këndoni** shpesh së bashku Himnin Trishenjtor, i cili ndodhet në këtë faqe. Kujtoni të bëni shenjen e kryqit sa herë që filloni të këndoni "Shenjt Perëndi".

## Mësimi 26

# Josifi ndihmon familjen e tij

## *Kur isha i uritur më dhatë ushqim për të ngrënë.*

Bazuar te Mateu 25:35



### Zbuloni

Ne mund të ndihmojmë në shumë mënyra. Shihni figurat.

Tregoni sesi po ndihmon dikë çdo fëmijë.

Qarkoni atë figurë që tregon sesi keni ndihmuar ju.



Zbuloni sesi e ndihmoi Josifi familjen e tij, në tregimin tonë nga Bibla.



## Shkrimi i Shenjtë

### Josifi ndihmon familjen e tij

Bazuar te Zanafilla 42

Për një kohë të gjatë asnjë bimë nuk ishte rritur në Kanaan, atje ku Jakobi jetonte me familjen e tij. Jakobi dërgoi djemtë e tij të blinin ushqim në Egjipt. Djali i tij i vogli, Benjamini, nuk shkoi me vëllezërit e tij.

Ata udhëtonin hipur mbi gomerët e tyre. Vëllezërit shkuan në pallatin e faraonit dhe takuan personin në ngarkim të shitjes së grurit. U përulën para tij dhe e pyetën nëse mund të blinin pak ushqim. Ata nuk e njohën që ai ishte vëllai i tyre Josifi, ai të cilin ua kishin shitur tregëtarëve nga Egjipti shumë vite më parë.

Josifi i njohu menjëherë që ata ishin vëllezërit e tij. Ai nuk u tregoi atyre se kush ishte por i pyeti: “- Kush jeni ju?”


Vëllezërit i thanë: “- Ne kemi ardhur nga Kanaani këtu, për të blerë ushqim për familjet tona.”

Josifi bëri sikur nuk i besoi. Ai i futi ata në burg për tri ditë. Më pas, Josifi u tha vëllezërve të tij:

“- Kthehuni në shtëpi dhe më sillni vëllanë tuaj të vogël! Atëherë do t’ju besoj. Deri atëherë do të mbaj këtu njërin prej jush.” Dhe ai mbajti Simeonin.

Vëllezërit i thanë njëri-tjetrit: “- Perëndia po na ndëshkon për atë që i bëmë Josifit shumë vite më parë!”

Josifi e kuptoi se çfarë thanë dhe mendoi me vete:



“- Ndoshta janë penduar për atë që më bënë shumë vite më parë.”  
Josifi u tha shërbëtorëve të vet të mbushnin thasët e vëllezërve të tij me grurë dhe të vendosnin paratë që ata kishin paguar për grurin, në thasët e tyre.



Kur mbërritën në shtëpi, ata ia treguan të gjitha atit të tyre: “- Duhet të marrim Benjaminin me vete, kur të shkojmë përsëri për të blerë ushqim. Zotëria egjiptian na tha që nëse ktheheshim me Benjaminin, atëherë do ta nxirrte Simeonin nga burgu dhe do të bëjmë lirshëm tregti në tokën e Egjiptit.”

Çfarë surprize patën kur të gjithë hapën thasët e tyre me grurë!  
Ndërsa hapte thesin e tij, secili gjente çantëzën e vet të parave!

Vendosni figurat e tregimit sipas radhës së ngjarjeve. Lidhni secilën figurë me numrin e duhur.





**Josifi ua  
ktheu paratë.**



**Josifi u shiti  
grurë atyre.**



**Ata erdhën për  
të blerë grurë.**



**Josifi i futi  
në burg.**

Jeta në Kishë


## Jisui na mëson të ndajmë gjërat me të tjerët

Bazuar te Mateu 25:34-40

Jisui u foli pasuesve të Tij duke thënë: “- Jeni të bekuar nga Ati im. Ju do të jeni gjithmonë miqtë e mi, sepse më dhatë ushqim kur isha i uritur dhe më dhatë ujë kur kisha etje.”

Miqtë e tij e pyetën: “- Zot, kur të pamë të uritur dhe të dhamë ushqim, apo kur të pamë të etur dhe të dhamë ujë për të pirë?”

Jisui tha:



Bëni një vizatim që tregon një rast kur keni ndarë ushqimin me dikë.





## Kreshma e Madhe është koha për të kujtuar

Gjatë Kreshmës së madhe, kisha na ndihmon të kujtojmë udhëzimet e Jisuit, për të ndihmuar të gjithë ata që kanë nevojë për ushqim. Neve na kërkohet të hamë ushqim të thjeshtë. Paratë që kursejmë sepse nuk blejmë karamelë apo ëmbëlsira, mund t'i përdorim për të blerë ushqim për ata që kanë nevojë.

Këtu keni disa gjëra të tjera që mund të bëjmë për të ndihmuar ata që nuk kanë mjaftueshëm për të ngrënë. Plotësoni fjalitë me fjalë nga lista e fjalëve. Qarkoni figurën e cila tregon se çfarë do të bënit për të ndihmuar.

### Fjalë Besimi

#### KRESHMA E MADHE

Koha për t'u bërë më shumë si Jisui.

*fqinjët*

*oborrit*

*ushqimin*

*shi*



Mos e çoni dëm \_\_\_\_\_ tuaj.



Lutuni për \_\_\_\_ dhe për kohë me diell që të rriten të mbjellat.



Çoni një pjesë të ushqimit te një nga \_\_\_\_\_ tuaj.



Ndihmoni një nga fqinjët në \_\_\_\_\_ e tij.

## Kisha lutet për fermerët

Prifti shkon në ferma dhe bekon arat në të cilat rritet ushqimi ynë. Lexoni lutjen së bashku me mësuesin tuaj.



*Beko o Zot*  *në qiell në mënyrë që të lëshojnë*



*të butë mbi arat tona.*

*Beko o Zot arat tona dhe ruaji nga çdo dëm,*

*ndërsa të*



*tona rriten në to.*

*Beko o Zot*



*dhe*



*e tyre në mënyrë që të*

*mbledhin të mbjellat e tyre me shëndet dhe lumturi.*

## KËNDI FAMILJAR

Tregimi nga **Zanafilla kapitulli 42**, për takimin e dhjetë djemve të Jakobit me vëllanë e tyre Josifin, të cilin ua kishin shitur shumë vite më parë tregtarëve egjiptianë, u ofron fëmijëve tanë mundësinë për t'i parë anëtarët e familjes të bashkëveprojnë. Përveç faktit që ky tregim paraqet shumë momente dramatike, të cilat mbërthejnë vëmendjen e fëmijëve, më i rëndësishëm është shembulli i anëtarëve të familjes që u tregojnë dhembshuri dhe interes, keqardhje dhe falje vëllezërve të cilëve u kishte humbur dashuria. Shembulli i faljes dhe dhembshurisë së Josifit, me siguri do të ngulitë dhe zhvillojë te fëmijët, rëndësinë e faljes e kujdesit kundrejt anëtarëve të familjes.

Mësimet e vetë Zotit tonë për kujdesin ndaj njëri-tjetrit, duke ndarë atë që kemi, zgjeron fokusin e këtij mësimi. Fëmijët mësuajnë të bëjnë zgjedhje për mënyrën sesi të vënë në jetë udhëzimet e Jisuit, për t'u kujdesur dhe ndarë. Ata u prezantuan edhe me idenë se Kreshma e Madhe është një kohë kur kisha na kujton të shtojmë përpjekjet tona, për të vënë në jetë këtë urdhërim hyjnor. Së bashku me fëmijën tuaj, vendosni të bëni disa nga sugjerimet e mëposhtme, si përforsim i mëtejshëm i mësimit:

1. Vëri t'ju **rithonë** tregimin për Josifin dhe vëllezërit e tij. Mund të hapni Biblën te **Zanafilla 42** dhe me ndihmën tuaj le të gjejnë emrin e Josifit dhe vargun i cili i referohet dhjetë vëllezërve.
2. Shkruani në një letër udhëzimet e Jisuit që gjenden te **Mateu 25:40** të cilat parafrazohen në këtë mësim te rubrika **Jeta në Kishë**. Vëreni fëmijën tuaj **të vizatojë** dhe ngjyrosë një kornizë zbukuruese rreth tekstit dhe ta vendosë në një vend ku mund ta shihni.
3. Bëjeni zakon **t'i mësoni** fëmijës suaj të shohë virtytin e lëmoshëdhënies gjatë gjithë vitit dhe veçanërisht gjatë Kreshmës së Madhe. Pak përpjekje për të ndarë me ata që kanë më pak se çfarë nevojitet është përjetim i vlefshëm.
4. Zhvilloni në ta një vetëdije për rëndësinë e punës së fermerëve, si një mënyrë për të siguruar ushqim për të gjithë. **Të luturit** për ta dhe të mbjellat e tyre është një tjetër mënyrë për t'u kujdesur dhe ndarë me ata që nuk kanë mjaftueshëm për të ngrënë.

# Të shkuarit mirë me anëtarët e familjes

Anëtarët e familjes kanë nevojë të mësojnë të shkojnë mirë me njëri-tjetrin. Kur vëllezërit dhe motrat kanë lënduar njëri-tjetrin, ata kanë nevojë të falin. Ndonjëherë kur dikush bëhet xheloz për një vëlla apo motër, prindërit u kujtojnë atyre që ata (prindërit), i duan në mënyrë të barabartë. Të jesh familje do të thotë që ne i përkasim njëri-tjetrit. Edhe në familjen e Perëndisë çdokush përfshihet dhe mirëpritet.



# Të shkuarit mirë me anëtarët e familjes



## *Për prindërit*

Fëmijët kanë nevojë për udhëzim dhe edukim, ndërsa rriten në marrëdhënien me anëtarët e familjes. Përjetimi i lëndimit të shkaktuar nga vëllezërit/motrat, nuk duhet lejuar të zgjasë, por duhet të pasohet nga falja.

⇒ Tregimi për Josifin që fal vëllezërit e tij, siguron një shembull të mirë. Rivaliteti midis fëmijëve në familje, natyrshëm i çon fëmijët të përjetojnë ndjenja xhelozie dhe pasigurie.

⇒ Tregimi për Birin Plangprishës u jep atyre sigurinë që prindërit i duan të gjithë fëmijët në mënyrë të pakushtëzuar.

⇒ Tregimi për kthimin e Kornelit pagan, në të krishterë, u tregon fëmijëve që në familjen e Perëndisë çdokush është i mirëpritur; dhe Lidia u jep atyre shembullin e mikpritjes së krishterë.

## Vëllezërit falin

***Jini të mirë me njëri-tjetrin, duke falur njëri-tjetrin,  
ashtu si Perëndia ju fali më Krishtin.***

Bazuar te Efesianët 4:32



### Zbuloni

Ndonjëherë shokët mund të lëndojnë njëri-tjetrin. Hiqni një vijë nga fjalët, të cilat tregojnë se me çfarë po lëndon secili fëmijë, te figura që e tregon atë.



Unë nuk e mora  
kukullën tënde.

*duke gënjyer*

*duke u tallur*

*duke vjedhur*



Duke e penguar  
që të rrëzohet.

Çfarë mund ta largojë lëndimin? Lidhni secilën figurë me fjalët e duhura.




*Vendos një fasho  
mbi plagë.*

*Ktheje kukullën.*



Fëmija i cili lëndoi shokun duhet të thotë “Më fal.”

Çfarë duhet të thotë fëmija i lënduar? “T\_\_ k\_\_m fal \_\_r.”



Zbuloni se çfarë i tha Josifi vëllezërve të tij në tregimin nga Bibla! 



## Shkrimi i Shenjtë

### Vëllezërit falin

Bazuar te Zanafilla 43-45; 46:5-7

Bijtë e Jakobit u kthyen përsëri në Egjipt, së bashku me vëllanë e tyre më të vogël, për të blerë grurë. Josifi i mirëpriti dhe i ftoi për darkë në shtëpinë e tij.

Josifi i pyeti: “- Si e keni babanë, a jeton ende ai?” Ata u përlulën para tij me respekt dhe i thanë: “- Ati ynë jeton ende dhe është shëndoshë e mirë.”



Duke parë Benjaminin, Josifi pyeti:


“- Ky është vëllai juaj më i vogël?”

“- Zoti im, ky është djali më i vogël i atit tonë. Nëse i ndodh gjë Benjaminit, ati ynë do të vdesë sepse shumë vite më parë ai humbi edhe një djalë tjetër, vëllanë tonë Josifin. Ai mendon se e sulmuan bishat.”


Josifi nuk mund t'i fshehte më ndjenjat e tij. Kur ishin vetëm, ai u tha atyre: “- Afrohuni ju lutem dhe më dëgjoni. Unë jam vëllai juaj Josifi, ai të cilin ua shitët tregëtarëve egjiptianë shumë vite më parë.”

Vëllezërit u shtangën. Ata kujtuan sesi ishin bërë xhelozë për vëllanë e tyre të vogël, Josifin dhe sesi e kishin shitur si skllav te tregëtarët egjiptianë. Ata u ndjenë shumë fajtorë për atë që kishin bërë.

Josifi vazhdoi: “- Mos u trishtoni dhe mos u mërzitni që më shitët në Egjipt. Gabimin që bëtë, Perëndia e ktheu në diçka të mirë. E shikoni, tani mund të ndihmoj familjen time.”



Vëllezërit me plot gëzim përqafulan dhe puthën vëllanë e tyre. Secili prej tyre tha: “- Të lutem më fal për gabimin që bëra ndaj teje”, dhe Josifi tha: “- Ju kam falur vëllezër.”



Josifi e ftoi familjen e tij të vinte e të jetonte në Egjipt. Vëllezërit u kthyen dhe sollën atin e tyre, gratë dhe fëmijët e tyre që të jetonin në Egjipt.

Zgjidhni fjalën e duhur për të plotësuar fjalitë.

**falur**    **u penduan**

Vëllezërit e Josifit \_\_\_\_\_ për atë që i kishin bërë vëllait të tyre.

Josifi tha: “Ju kam \_\_\_\_\_ vëllezër.”

Jeta në Kishë

## Jisui na mëson të falim

Jisui u foli dishepujve të tij për të shkuarit mirë me njëri-tjetrin. Ai u tha: “- Duhet të jeni të kujdesshëm të mos bëni atë që është e gabuar. Por nëse ndonjë nga pasuesit e mi bën gabim dhe ju lëndon, flisni me të dhe përpiquuni t’i rregulloni gjërat.”

Pjetri pyeti Jisuin: “- Zot, sa herë duhet ta fal dikë që bën diçka të gabuar kundër meje? A mjafton ta fal shtatë herë?”

Jisui iu përgjigj:

“- Jo vetëm shtatë,  
por shtatëdhjetë herë shtatë, e më shumë!”

Bëni një vizatim për një rast kur keni falur vëllanë apo motrën për gabimin që bëri kundër jush.



### Fjalë Besimi

#### FAL

Të mos jesh  
më i zemëruar  
me dikë.

Qarkoni dy fjalë që përshkruajnë sesi u ndjetë pasi falët.

i zemëruar

i lumtur

i trishtuar

i gëzuar



## Kujtohuni të falni

Ndërsa lutemi me lutjen e Zotit kujtojmë fjalët e Jisuit për faljen e njëri – tjetrit.

Ati ynë që je në qiejt,  
u shenjtëroftë emri Yt,  
ardhtë Mbretëria Jote,  
u bëftë dëshira Jote,  
si në qiell ashtu dhe mbi dhé,  
bukën tonë të përditshme, jepna neve sot,

dhe **fal**na fajet **tona**  
sikurse dhe **ne** ua **falim**  
fajtorëve tanë.

Dhe mos na shtjer në ngasje,  
por shpëtona nga i ligu.  
Amin.

Ngjyrosni fjalët: falna dhe falim me **lejla**, tona me **të gjelbër**, ne me **blu**.

Hiqni një vijë nga figura te fjalët e duhura, për të plotësuar fjalitë.

Bëra gabim...



më fal

të fal

Më lëndove. Unë....



## Të jetuarit së bashku në paqe

Gjeni shkronjat të cilat përputhen me ngjyrat në secilën hapësirë boshe dhe plotësoni fjalët. Më pas lexoni këtë lutje së bashku me mësuesin tuaj. Lutuni me këtë lutje çdo ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje.

\_\_\_shtë me të vërtet e mrekullueshme kur  
të \_\_\_fërm\_\_\_t dhe shok\_\_\_t jetojnë  
së b\_\_\_shku në p\_\_\_qe.

e

i

a

## KËNDI FAMILJAR

Ky mësim është i pari nga katër mësimet që merren me marrëdhëniet familjare. Të shkruarit mirë me anëtarët e familjes është themeli për një marrëdhënie të paqshme me anëtarët e komunitetit dhe shoqërinë në përgjithësi, gjë e cila përfundimisht kontribuon për paqen në botë.

Në këtë tregim, Josifi fal vëllezërit e tij për keqtrajtimin që i kishin bërë, duke e shitur atë te tregtarët egjiptianë, shumë vite më parë. Ky tregim vazhdon me situatën, në të cilin Josifi ndihmon vëllezërit e tij, duke u shitur grurë gjatë zisë së bukës, pa u njohur prej tyre. Në këtë tregim, Josifi fal vëllezërit e tij. Ajo që vjen më pas është një shembull i mrekullueshëm i faljes dhe i kërkesës për falje.

Mësimi zgjerohet me mësimin e vetë Jisu Krishtit për faljen, te **Mateu 18:21-22**. Fëmijëve u jepet një mundësi për të reflektuar mbi eksperiencat e tyre të faljes, nëpërmjet punës së dorës dhe më pas të mendojnë për fjalët të cilat i themi çdo ditë në Lutjen e Zotit: “Falna fajet tona, sikurse ne ua falim fajtorëve tanë.” **Vargu 1 i Psalmi 133** i lë fëmijët me porosinë për të jetuar në paqe.

**Së bashku me fëmijën tuaj, zgjidhni të bëni disa nga sugjerimet më poshtë, për të mbjellë dhe zhvilluar frymën e faljes te fëmija:**

1. Vëriini të bëjnë një vizatim për tregimin e Josifit që fal vëllezërit dhe t’jua thonë këtë tregim me fjalët e tyre.
2. Në Biblën tuaj gjeni pasazhin te **Mateu 18:21-22** dhe lexojeni së bashku me fëmijën tuaj.
3. **Lutuni** me lutjen e Zotit së bashku, me ngadalë, në mënyrë që fëmija të kushtojë vëmendje ndërsa thoni: “Falna fajet tona, sikurse ne ua falim fajtorëve tanë.”
4. Shkruani fjalët e **vargut 1 të Psalmi 133** me shkronja të mëdha në një letër. Vëriini fëmijën tuaj të vizatojë një kornizë zbukuruese dhe ta vendosë atë në një vend ku mund të shihet lehtë dhe shpesh.
5. **Bëni** një tabelë me dy kollona. Një kollonë duhet të lexojë ‘Fala’ dhe tjetra ‘Kërkova falje’. Mbani shënim çdo rast kur një anëtar i familjes fal ose kërkon falje. Si familje, vini re sesa shumë i paqshëm dhe i lumtur është kushdo kur fal.

## Mësimi 28

### Vëllai i madh bëhet xheloz

***Biri im, ti je gjithmonë me mua dhe gjithçka që kam është e jotja.***

Bazuar te Llukai 15:31



#### Zbuloni

Shihni figurën dhe thoni se çfarë po ndodh në të. Cilat fjalë do të tregonin sesi ndjehet fëmija më i madh?

Vendosni një ✓ pranë fjalës që zgjedhët.



\_\_\_ **i zemëruar**    \_\_\_ **i entuaziazmuar**    \_\_\_ **i lumtur**  
\_\_\_ **xheloz**    \_\_\_ **i trishtuar**    \_\_\_ **i lënë mënjanë**

A ka patur ndonjë rast kur jeni ndjerë si fëmija në figurë?  
Bëni një vizatim për ta treguar atë.



Në tregimin tonë nga Bibla zbuloni se kush u ndje xheloz!



## Shkrimi i Shenjtë


### Vëllai i madh bëhet xheloz

Bazuar te Llukai 15:11-32

Jisui u tha këtë tregim miqve të tij:

Djali më i vogël i një njeriu të pasur i tha atit të tij:  
“- Më jep pjesën time të pasurisë. Dua të iki larg.”


Djali i vogël shkoi në një vend shumë të largët. Ai bënte festë gjatë gjithë kohës. Kur paratë iu mbaruan, të gjithë miqtë që pati e braktisën.



Nuk kishte më ushqim për të ngrënë. Ai shkoi të punonte si kujdestar derrash. Do të kishte qenë shumë i lumtur nëse do të hante çfarë hanin derrat, por askush nuk i jepte për të ngrënë.

Në fund vendosi të kthehej te ati i tij dhe t'i kërkonte falje. Ai do të punonte si shërbëtor për të. Nga shumë larg ati e pa të kthehej. Ai pati dhembshuri për djalin e vet. Vrapoi tek ai, e përqafoi dhe e puti.

“- Atë, kam mëkatuar kundër Perëndisë që është në qiell dhe kundër teje. Nuk jam më i denjë të quhem djali yt. Më merr si një nga shërbëtorët e tu.”





Por ati i tij urdhëroi shërbëtorët e vet të sillnin roba të mira për djalin e tij dhe të bënë gati festën për të kremtuar.

Oh, sa shumë xheloz u bë djali i madh kur mori vesh për festën që bëhej për vëllanë e tij. Ai nuk donte të shkonte brenda në shtëpi, madje edhe kur i ati shkoi jashtë dhe iu lut të hynte. “- Atë, jam i zemëruar sepse kurrë nuk më ke dhënë diçka për të festuar me miqtë e mi. Por bëre festë për djalin që prishi paratë e tua, pikërisht sapo ai u kthye!”

Ati i vuri duart mbi shpatullën e djalit të madh dhe i tha: “- Biri im, ti je gjithmonë me mua dhe gjithçka që kam është e jotja. Por duhet të jemi të gëzuar dhe të festojmë! Vëllai yt ishte i vdekur, por tani është gjallë. Ai kishte humbur dhe tani u gjend.”



Gjeni dhe ngjyrosni fjalët të cilat tregojnë sesi vëllai i madh mund të jetë ndjerë kur ati i vuri duart mbi shpatulla dhe i foli.

**I TRISHTUAR**

**I ZEMËRUAR**

**I DASHUR**

**I LUMTUR**

Jeta në Kishë

## Kur ndjehem xheloz Perëndia më ndihmon

Perëndia e di që kur ndjehemi xhelozë bëhemi shumë të trishtuar. Kjo është arsyeja pse Perëndia na mëson të mos jemi xhelozë për njëritjetrin. Perëndia thotë:

*Mos ji xheloz për vëllanë, motrën apo shokun tënd.*

*Përkundrazi duajini ata aq shumë sa dhe Perëndia ju do juve.*

Bazuar te Eksodi 20:17 dhe Joani 14:21

Figurat në të majtë tregojnë raste kur mund të ndjeheni xhelozë. Hiqni një vijë nga secila figurë në të majtë te ajo në të djathtë që ju ndihmon të tregoni dashuri.



## Ne mund të tregojmë dashuri

Jisui na thotë pse duhet të pushojmë së qëni xhelozë dhe të tregojmë dashuri për njëri-tjetrin. Kjo është ajo çfarë Ai thotë:



*Doni çdokënd, edhe atë që nuk sillet mirë ndaj jush, në mënyrë që të bëheni bijë të Atit në qiell.*

*Perëndia e bën diellin të shkëlqejë mbi njerëzit e mirë dhe mbi njerëzit e këqinj.*

*Kështu që ju duhet të veproni gjithmonë, ashtu si Ati juaj në qiell.*

Bazuar te Mateu 5:44-47

*Ji i lumtur, kjo është ajo që Perëndia të thotë.*

*Unë, Zoti, të krijova ty \_\_\_\_\_.*

*Të kam thirrur në emër, tani më përket mua. Unë*

*jam Perëndia yt. Ti je i shtrenjtë për mua dhe unë*

# Të dua ty!

Bazuar te Isaia 43:1-4

Unë i them Perëndisë:  
Faleminderit që më \_\_\_\_\_ mua.



### Fjalë Besimi

#### DASHURI

Perëndia tregon dashurinë duke u kujdesur për ne dhe duke na mbrojtur.

## Këndojmë: *Kjo është porosia*

*Kjo është porosia, që të doni njëri-tjetrin  
që gëzimi të jetë i plotë ( 2 herë)*

*Që gëzimi të jetë i plotë (2 herë)*

*Kjo është porosia, që të doni njëri-tjetrin  
që gëzimi juaj të jetë i plotë.*

### KËNDI FAMILJAR

Xhelozia është një ndjenjë njerëzore, të cilën e përjetojnë shpesh të vegjël e të mëdhenj. Nëse përballohet si duhet gjatë fëmijërisë, xhelozia nuk do të jetë më një ndjenjë skllavëruese. Në tregimin e sotëm për Djalë Plangprishës, fokusi nuk është mbi djalin e vogël, i cili la shtëpinë dhe prishi paratë e atit të tij, por mbi djalin e madh, i cili me plot bindje dhe dashuri qëndroi me atin në shtëpi.

Kjo paravoli e dhënë nga Zoti, na tregon që djali i madh përjetoi ndjenjat turbulluese të xhelozisë, kur djali i vogël në kthimin e tij, u prit me dashuri nga ati. Xhelozia ushqehet nga ndjenjat tona të pasigurisë, frikës se mos nuk na duan. Reagimi i atit në paravoli tregon sesi kujdeset ai për djalin e madh, duke e siguruar që ai e ka dashur gjithmonë dhe do të vazhdojë ta dojë.

Si prindër, ne mund t'u ofrojmë fëmijëve tanë të njëjtën ndjenjë sigurie që vjen nga dashuria që u jepet. Ashtu si ati në paravoli nuk e lidhi dashurinë e tij me kushtin e sjelljes së mirë, si prindër ne thirrmi të mos e lidhim shprehjen e dashurisë sonë me sjelljen e duhur të fëmijëve, por me durim dhe dashuri të udhëzojmë fëmijën drejt sjelljes së dëshirueshme.

Këtu janë disa gjëra, të cilat mund t'i bëni së bashku si familje:

1. Vëreni fëmijën tuaj **të luajë si dramë** tregimin, së bashku me vëllezërit, motrat apo shokët.
2. Pas dramatizimit, inkurajojini fëmijët **të flasin** për mënyrën sesi u ndjenë ndërsa luanin dramën. I pyesni nëse janë ndjerë ndonjëherë si djali i madh, xheloz, apo të lënë pas dore. **Bisedoni** për të së bashku me fëmijët, por pa fajësuar.
3. Me një përqaftim dhe fjalë **të dashura**, siguroni fëmijën tuaj që ju e doni në mënyrë të pakushtëzuar.
4. Së bashku me fëmijën tuaj **shkruani** fjalët që ndodhen te **Isaia 43:1-4** në formë të përmbledhur në një shirit letre dhe vendoseni diku ku mund të shihet:  
**“Unë, Zoti Perëndi të kam thirrur në emër. Ti je i imi. Unë të dua.”**



Mësimi 29

## Familja e Perëndisë përfshin çdo njeri

***Të gjithë ju jeni vëllezër dhe motra më Krishtin Jisu.***

Bazuar te Galatianët 3:28



Zbuloni

Anëtarët e familjes sime janë nga vende të ndryshme. Ne jemi një familje e madhe dhe e lumtur.

Me një vijë lidhni secilin vend me veshjen karakteristike, duke përdorur të dhënat e ngjyrave.



***Tirana***



***Vlora***



***Saranda***



unë

Zbuloni të tjera familje që kanë njerëz të cilët janë nga vende të ndryshme.

## Shkrimi i Shenjtë

### Familja e Perëndisë përfshin çdo njeri

Bazuar te Veprat e Apostujve 10

Në një qytet shumë larg Jeruzalemit, Korneli, një pagan, jetonte së bashku me familjen e tij. Ata e donin Perëndinë. Ndhomonin të varfërit dhe gjithmonë i luteshin Perëndisë dhe e lavdëronin Atë. Një engjëll i Zotit erdhi te ai dhe i tha: “- Kornel, Perëndia i ka dëgjuar lutjet dhe lëmoshat e tua. Tani dërgo disa njerëz në qytetin e Jopës që të të sjellin një njeri të quajtur Pjetër.”



Korneli dërgoi tre njerëz në Jopë për të marrë Pjetrin.

Në Jopë, Pjetri po lutej mbi tarracën e shtëpisë së mikut të tij, Simonit. Ndërsa po priste ushqimin, ai pa një ëndërr. Diçka që ngjante si një çarçaf i madh u ul nga qielli, i kapur nga katër cepat. Brenda tij gjendeshin të gjitha llojet e kafshëve, zogj fluturues dhe zvarranikë.

Një zë i tha Pjetrit: “- Pjetër, merr kafshët, gatuaji dhe haji.” Pjetri tha: “- Jo, Zot, familja ime nuk ha ndonjë nga këto kafshë.” Zëri foli përsëri: “- Pjetër, nëse Perëndia t’i jep, atëherë duhet t’i hash.”

Pikërisht në atë moment erdhën njerëzit e Kornelit për të kërkuar Pjetrin. Perëndia i tha Pjetrit të shkonte me këta njerëz. Kur arritën te shtëpia e Kornelit, Korneli dhe familja e tij e mirëpritën Pjetrin.

Pjetri tha: “- E dini që jam jude dhe nuk është e drejtë që të vizitoj e të bëj diçka me njerëz që nuk janë judenj.

Por Perëndia më ka shfaqur që duhet t'i pranoj të gjithë njësoj. Pra, më thoni pse deshët të më takonit?"

Korneli tha: "- Një engjëll më tha të dërgoja njerëz për t'ju marrë. Tani jemi gati të dëgjojmë gjithçka, që Perëndia ju ka kërkuar të na tregosh."

Pjetri tha: "- E kuptoj që Perëndia nuk mban me hatër. Ai pranon të gjithë ata që e duan dhe veprojnë me drejtësi. Kështu që më lini t'ju tregoj për Jisu Krishtin, i cili predikoi në gjithë vendin e Judesë.



Jisui lindi në Betlehem dhe u

pagëzua nga Joani. Ai ndihmonte njerëzit, shëronte të sëmurët dhe u sillte shpresë e gëzim të gjithëve. Disa njerëz që nuk e donin Jisuin e kryqëzuan atë. Ai vdiq, por tri ditë më vonë Perëndia e ngjalli prej së vdekurësh. Miqtë e mi, kujtudo që beson te Jisu Krishti do t'i falen mëkatet." Papritmas, Shpirti i Shenjtë erdhi dhe qëndroi mbi të gjithë ata që po e dëgjonin. Miqtë judenj të Pjetrit u habitën që Shpirti i Shenjtë erdhi mbi Kornelin dhe familjen e tij, të cilët nuk ishin judenj. Ata panë dhe dëgjuan ata njerëz të lavdërojnë Perëndinë.

Më pas Pjetri tha: "- Këta njerëz kanë marrë Shpirtin e Shenjtë ashtu si edhe ne. Si mundet që të mos i pagëzojmë! Sillni ca ujë!"

Dhe Pjetri urdhëroi që ata të pagëzohen në emrin e Jisu Krishtit.

## Fjalë Besimi

### KORNELI

Pjetri e pagëzoi Kornelin që të bëhej pasues i Jisu Krishtit.

Jeta në Kishë

## Vëllezër dhe motra më Krishtin

Anëtarët e familjes nuk janë të gjithë njësoj. Gjithashtu kemi fqinjë që janë të ndryshëm nga ne. Mund të mos i përkasin të njëjtit vend. Si duhet t'i trajtojmë ata?

Shën Pavli u tha këto fjalë disa të krishterëve:

*“Kur pagëzoheni në emrin e Jisu Krishtit  
bëheni të gjithë fëmijë të Perëndisë.  
Nuk ka rëndësi nëse jeni grekë apo judenj,  
grua apo burrë; të gjithë jeni  
vëllezër dhe motra më Krishtin Jisu.”*

Bazuar te Galatianët 3:27-28



## Shën Nina shkon në një vend të huaj

Nina ishte një vajzë e krishterë, e cila jetonte në kohën e sundimit të Shën Kostandinit. Një natë, Nina pa një ëndërr, në të cilën Shën Maria, nëna e Jisuit, erdhi tek ajo dhe i tha: “- Shko në vendet në veri dhe prediko lajmin e mirë të Perëndisë”. Atëherë, Shën Maria këputi një degë hardhie dhe i dha formën e kryqit, duke thënë: “- Me fuqinë e këtij kryqi, ti do të jesh në gjendje të mundësh armiqtë dhe të predikosh mesazhin tënd”. Kur Nina u zgjua, kryqi ishte në duart e saj.

Nina udhëtoi për shumë javë mes maleve me hajdutë, arinj dhe ujqër, duke arritur më në fund në tokën e Iberisë (sot është shteti i Gjeorgjisë). Disa njerëz miqësorë e ndihmuan shën Ninën dhe ajo mësoi prej tyre gjuhën e vendit. Shumë njerëz filluan ta vizitonin Ninën dhe ajo u mësonte atyre rreth Jisu Krishtit. Edhe pse ishte e huaj në atë vend, shën Nina e ndjente veten motër me njerëzit e vendit, për shkak se të gjithë e donin Jisu Krishtin. Përmes lutjeve të saj, shumë njerëz të sëmurë u shëruan. Një ditë, vetë mbretëresha erdhi ta vizitonte, pasi ishte shumë e sëmurë. Kur Nina bëri shenjën e kryqit mbi të dhe mbretëresha u shërua.

Shën Nina vazhdoi të udhëtonte dhe mësonte për Perëndinë gjatë gjithë jetës së saj, sa që edhe në ditët e sotme ajo nderohet si “nëna e Gjeorgjisë”.


1. udhëtoi
2. e ndjente
3. u mësoi
4. u shëruan

*Përdorni listën e fjalëve për të shkruar shkronjat që mungojnë.*




## Shumë njerëz, një familje e Kishës

Shumë njerëz të ndryshëm përbëjnë Kishën. Shumë ngjyra bëjnë një pikturë të bukur. Përdorni kodin e ngjyrave për të ngjrosur figurën. Çfarë shihni?



1 2 3 4 5



### KËNDI FAMILJAR

Fjalët e Shën Pavlit në letrën e tij drejtuar Kishës Galatiane, pohojnë qëllimin e këtij mësimi, që familja e kishës përbëhet nga të gjitha llojet e njerëzve, por ata të gjithë janë një dhe të njëjtë në sytë e Perëndisë, sepse ata i përkasin familjes së Tij.

Tregimi ynë nga Shkrimi i Shenjtë, na paraqet Kornelin, i cili u bë pagani i parë apo i kthyeri i parë jo-jude, në besimin e krishterë. Apostull Pjetri pohon porosinë e Jisu Krishtit për të “shkuar dhe bërë dishepuj në të gjitha kombet, duke i pagëzuar në emrin e Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë...” (**Mat. 28:19**), kur i thotë atyre që ishin mbledhur në shtëpinë e Kornelit: “Në të vërtetë unë po e marr vesh se Perëndia nuk tregohet i anshëm; por në çfarëdo kombi, ai që ka frikë prej Tij dhe që vepron drejtësisht është i pranuar nga Ai.” (**Veprat e Apostujve 10:34-35**) Sipas besimit orthodhoks, të gjithë që pagëzohen në emrin e Trinisë së Shenjtë janë vëllezër dhe motra, pavarësisht identitetit të tyre kombëtar apo etnik. Nëse u mësojmë të tjerëve diçka të ndryshme nga kjo, mohojmë fjalën e Perëndisë.

Fëmijët tanë të vegjël kanë nevojë të mësojnë të pranojnë njëri-tjetrin me dashuri, veçanërisht kur i përkasin trupit të Krishtit, Kishës së Shenjtë. Në rubrikën **Jeta në Kishë** të këtij mësimi, fëmijëve u mësohet që nëpërmjet pagëzimit, të gjithë ata bëhen anëtarë të së njëjtës familje. Më tej, nëpërmjet shembullit të Shën Ninës, atyre u jepet e përbashkëta që kishte shenjtorja me njerëzit e vendit të Iberisë, dashuria për Jisu Krishtin, ndërsa predikonte Ungjillin e Tij dhe bëhej shkak për kthimin e popullit të atij vendi në krishtërim.

Ndihmoheni fëmijën tuaj të rritet në dashurinë e krishterë për të gjithë që thërrasin emrin e Zotit me anë të pagëzimit të tyre. Këtu keni disa gjëra që mund të bëni:

1. **Mësojini** fëmijët tuaj të jenë të sjellshëm dhe mikpritës ndaj fëmijëve që takojnë, të cilët mund të mos jenë anëtarë të komunitetit të tyre. **Inkurajojini** të luajnë me çdokënd në grup, pa përjashtuar asnjë fëmijë.
2. **Shkruani** vargun e mëposhtëm “**Pagëzimi na bën vëllezër dhe motra më Krishtin.**” Vëreni fëmijën tuaj ta ilustrojë atë dhe ta vendosë diku, ku të gjithë mund ta shohin.
3. **Gjeni** një fëmijë në komunitetin tuaj, i cili akoma nuk ka filluar të vijë në katekizëm dhe kërkoni nga fëmija juaj ta ftojë atë t’i bashkohet grupit të katekizmit.

## Mësimi 30

# Lidia mirëpret familjen e Perëndisë

## *I mirëprisni njerëzit me gëzim në shtëpinë tuaj.*

Bazuar te I Pjetrit 4:9



### Zbuloni

Familja ime kënaqet kur kemi mysafirë në shtëpi. Nëna fillon të merret me përgatitjen për mysafirët. Ajo na kërkon ndihmë për të bërë gati shtëpinë.

Shihni figurën dhe lidhni fjalët me atë që po bëhet nga familja. Shkruani numrin e saktë në secilin rreth.



1 vendoset një vazo lulesh

2 fshihet

3 rregullohet dhoma

4 pastrohen pluhtrat

5 gatohen biskotat

Tani ngjyrosni lulet dhe biskotat. Më pas zbuloni në tregimin tonë nga Bibla se kush tjetër dëshironte të priste mysafirë.

## Shkrimi i Shenjtë

### Lidia mirëpret familjen e Perëndisë

Bazuar te Veprat e Apostujve 16:1-15

Apostull Pavli shkante nga qyteti në qytet, së bashku me mikun e tij, Silën, duke u treguar njerëzve për Jisu Krishtin. Çdo ditë njerëz të rinj besonin te Jisu Krishti. Ata i bashkoheshin kishës, familjes së Perëndisë.

Ishte e vështirë të udhëtoje në kaq shumë vende të largëta. Por Pavli dhe Sila donin që çdokush të dëgjonte për dashurinë e Jisu Krishtit, Perëndisë tonë. Ata udhëtonin në tokë, si dhe lundronin në det.

Një ditë, ata hipën në një varkë dhe shkuan në një qytet të madh të quajtur Filipi. Pavli i tha mikut të tij: “- Le të pushojmë për pak ditë. Më pas do të shkojmë të takojmë disa miq.”



Ditën e shtunë ata shkuan në një vend afër lumit, ku njerëzit mblidheshin për lutje. Atje kishte ardhur një grup grash. Pavli dhe Sila u ulën me to dhe u folën. Pavli tha: “- Motra, kam lajme të mira për ju. Perëndia dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jisu Krishtin, që të na ndihmojë. Ai na mësoi si të bëhemi miq me Perëndinë, shëronte të



sëmuret, ndihmonte të varfërit dhe na mësoi si të duam Perëndinë e njëri-tjetrin. Disa njerëz e kryqëzuan Atë. Ai vdiq, por Perëndia e ktheu përsëri në jetë.”

Grave iu pëlqeu ajo që dëgjuan dhe thanë: “- Na thuaj më shumë për Jisuin.” Pavli vazhdoi: “- Çdokush që beson te Jisui dhe e do Atë, do të jetë miku i Perëndisë përgjithmonë.”

Njëra nga gratë që dëgjuan Pavlin, quhej Lidia. Ajo ishte nga një qytet i madh, ku shiste copa të bukura për rroba. Perëndia e ndihmoi të besonte gjithçka që Pavli dhe Sila thanë.

Lidia kërkoi të pagëzohej. Më pas i tha Pavlit dhe Silës: “Nëse mendoni se jam besnike ndaj Zotit, ju lutem ejani dhe qëndroni në shtëpinë time.”

Lidia i bëri mysafirët e saj të ndjehen të mirëpritur në shtëpinë e saj.

### Fjalë Besimi

#### MIKPRITJE

Kur hapni derën dhe i uroni mirëseardhjen një mysafiri.

*Ngjyrosni shtëpinë e Lidias dhe bëjeni të duket e bukur për mysafirët e saj.*



Jeta në Kishë

## Shën Makrina

Makrina ishte një vajzë shumë e lumtur.

Ajo kishte një familje të mrekullueshme, e cila donte shumë të kishte mysafirë në shtëpinë e saj. Makrina mësonte të donte Jisu Krishtin nga gjyshja, babai dhe nëna e saj.

Prindërit e Makrinës kishin një shtëpi shumë



të madhe. Ashtu si gjyshja, edhe ata ftonin njerëz në shtëpinë e tyre e tregoheshin të mirë me ta. Ata ndanin gjithashtu çka kishin, me të varfërit. Kur babai i Makrinës vdiq, ajo ndihmonte nënën e saj të kujdesej për shtëpinë. **Makrina të gjithë i trajtonte me respekt.** Ajo shiti mobiljet e shtrenjta të shtëpisë dhe ua dha paratë të varfërve.

Makrina i trajtonte shërbëtorët si vëllezër dhe motra. **Ata uleshin të gjithë në tryezë dhe hanin së bashku.**

**Makrina dhe nëna e saj e bënë shtëpinë e tyre një vend ku çdokush ishte i mirëpritur.** Me mysafirët e tyre ato hanin, bisedonin, mësonin për Jisu Krishtin dhe gjithmonë luteshin.

Si e tregonte Makrina dashurinë e saj për Jisuin?

Në secilën fjali të ngjyrosur qarkoni fjalën e cila tregon sesi i trajtonte mysafirët e saj Makrina dhe shkruajeni atë pranë numrit përkatës.

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

## Ne mirëpresim të tjerët në familjen e Perëndisë

Shihni figurat për mikpritjen. Në secilin çift fjalish gjeni zgjedhjen më të mirë. Nënvizojeni atë.



- Nuk dua që ajo të luajë me ne.
- Le të shkojmë dhe t'i kërkojmë të luajë me ne.



- Nuk më pëlqen ky djalë, le të shkojmë të luajmë.
- Eja me ne, do t'ia kalojmë mirë në katekizëm.

## Ne përshëndesim njëri-tjetrin me puthjen e paqes

Jisui na fton të jemi mysafirë në darkën e Tij të veçantë, Eukaristinë Hyjnore. Gjatë Liturgjisë Hyjnore ne përshëndesim çdo njeri në kishë me Puthjen e Paqes. Ja fjalët e kësaj përshëndetjeje:



*Krishti mes nesh.*

*Ishte, është dhe do të jetë.*

Së bashku me mësuesen tuaj mësoni të jepni Puthjen e Paqes.

### KËNDI FAMILJAR

Mikpritja është një cilësi që fëmijët mund ta mësojnë lehtë nga prindërit e tyre. Mirëpritja e mysafirëve, qofshin të familjes apo miq, është karakteristike për të gjitha kulturat dhe detyrë për të gjithë të krishterët. Në letrën drejtuar Hebrenjve, të krishterët nxiten si më poshtë: “Mos harroni mikpritjen, sepse nëpërmjet saj, disa, pa ditur, pritën engjëj në shtëpi.” (**Hebrenjtë 13:2**)

Në letrën e parë të **Shën Pjetrit 4:9** përsëri: “Jini mikpritës njëri me tjetrin, pa murmuritur.”

Në tregimin e shkurtër të kthimit të Lidias në krishtërim, fëmijët takojnë një grua që praktikonte mikpritjen e krishterë dhe ndihmonte apostull Pjetrin në shërbesën e tij. Mësimi u zgjerua me jetën e kishës së hershme nëpërmjet dëshmisë për Shën Makrinën, motrën e Shën Vasilit të Cesaresë dhe Shën Grigor Naziansit. Tërë jeta e saj reflekton mikpritje, që lind nga dashuria për Krishtin.


Në fund, fëmijëve iu dha mundësia për të zbatuar këtë virtyt të krishterë, në rrethanat e jetës së përditshme. Vazhdoni të ushqeni mikpritjen te fëmijët tuaj.

1. **Përfshijini** në planifikimin e pritjes së mysafirëve në shtëpi.
2. **Mësojini** të jenë bujarë me kohën e tyre dhe të luajnë me fëmijët që janë mysafirë në shtëpinë tuaj.
3. Vëri **të dëgjojnë** gjyshërit apo fqinj më të mëdhenj, që mund t’u thonë tregime nga jeta e tyre, të cilat flasin për mikpritje.
4. **Ftojini** klasën e katekizmit të fëmijës suaj, të zhvillojë një nga orët në shtëpinë tuaj, nëse është e mundur.

## Kapitulli 9

# Anëtarët e familjes bëjnë shumë gjëra së bashku

Anëtarët e familjes bëjnë shumë gjëra së bashku. Ata ndihmojnë njëri-tjetrin, adhurojnë Perëndinë së bashku në Kishë, kremtojnë raste të veçanta me miqtë, vizitojnë të afërm e miq dhe pranojnë mysafirë në shtëpinë e tyre.



# Anëtarët e familjes bëjnë shumë gjëra së bashku



## *Për prindërit*

Katër tregimet nga Shkrimi i Shenjtë të përzgjedhura për këtë kapitull, nxjerrin në pah gjërat e shumta që anëtarët e familjes bëjnë së bashku.

★ Paravolia e dy bijve, te *Mateu 21:28-32*, flet për mënyrën sesi ndihmojnë njëri-tjetrin anëtarët e familjes.

★ Tregimi për udhëtimin e familjes së Jisuit 12 vjeçar, te *Llukai 2:41-52*, tregon rëndësinë e adhurimit familjar.

★ Pjesëmarrja e familjes në ndihmesën që u jepet miqve për të krentuar çastet e lumtura, na jepet te *Joani 2:1-11*, ngjarja e dasmës në Kana, ku morën pjesë Jisui dhe nëna e Tij.

★ Në fund, kënaqësia e pritjes së miqve në shtëpi, paraqitet te *Llukai 10:38-42*, në tregimin e mikpritjes së Martës dhe Marisë.

## Mësimi 31

# Paravolia e dy bijve

## *O Zot, bëhu Ti ndihma ime!*

Bazuar te Psalmi 30:10



### Zbuloni

Fëmijët ndihmojnë prindërit e tyre duke bërë punë të vogla. Mendoni për mënyrën sesi mund të ndihmoni prindërit tuaj në shtëpi.

Shënoni një  $\checkmark$  në secilën figurë që tregon sesi i ndihmoni ju prindërit.



Vizatoni një tjetër mënyrë që ju pëlqeni të ndihmoni nënën dhe babanë.

Lexoni tregimin nga Bibla për të zbuluar sesi e ndihmuan vëllezërit, atin e tyre.




## Shkrimi i Shenjtë

### Jisui thotë një tregim për dy bij

Bazuar te Mateu 21:28-32

Duke filluar nga numri 1 vendosni numrat në secilën fletë tregimi, sipas radhës së duhur, së bashku me mësuesin tuaj.


1




“-Djema, sot më duhet ndihma juaj për të vjelë rrushin e pjekur. A mund të vini te vreshti?”



Benjamini u përgjigj menjëherë: “-Baba, sot do të shkoj të peshkoj. Nuk mund të të ndihmoj. Rrushi mund të presë deri nesër.”



Benjamini mendoi: “-Duhet t’i kisha thënë po babait. Ai ka nevojë për ndihmë që të vjelë rrushin para se të fillojnë shirat.” Më pas shkoi me vrap te vreshti.



Ati pyet djalin e tij të vogël: “-Po ti, Andrea?” “-Patjetër baba, do të vij të të ndihmoj.” – u përgjigj Andrea. Por nuk shkoi për ta ndihmuar.





5

Ati punonte shpejt. “-Oh, do të doja që bijtë e mi të ishin këtu të më ndihmonin. Kam frikë se do të humbasë pjesën më të madhe të rrushit nëse bie shi!”



“Baba, ndryshova mendje. Erdha për të të ndihmuar. Mund të luaj nesër gjatë gjithë ditës, por rrushi nuk mund të presë.”



“-Faleminderit Benjamin që ndryshove mendje. Nuk mund ta kisha mbaruar i vetëm vjeljen.” Benjamini u ndje shumë i lumtur!



Andrea hyri në shtëpi. “Bir, ti the që do të vije dhe unë të prita. Ku ishte?” Andrea e kuptoi që kishte bërë gabim duke mos e mbajtur premtimin.

Gjeni shkronjën e cila shkon me numrin dhe shkruajeni në veshin e rrushit. Do të kuptoni se çfarë i tha ati Benjaminit.

l 3 a 2 i 11 e 9 m 5 e 4 r 10 t 12 n 7 f 1 d 8 i 6



Jeta në Kishë

## Ç'loj ndihmësi jam unë?

Prindërit ju kanë kërkuar për t'i ndihmuar me punëra të vogla në shtëpi. Si ndjeheni kur ju kërkojnë të bëni diçka për ta?

Në tregimin tonë, Benjamini nuk donte të ndihmonte, por më vonë i erdhi keq dhe ndryshoi mendje. Vëllai i tij i vogël, Andrea, i tha "po" atit të tij, por kurrë nuk shkoi për ta ndihmuar.

Keni qenë ndonjëherë si Benjamini apo Andrea? Shihni çiftet e figurave dhe vendosni një X pranë asaj e cila tregon sesi do të ishit sjellë.



- Maria, të lutem më ndihmo të shtrojmë tryezën.



- Andrea, mund ta nxjerrësh jashtë koshin e plehrave?



Bëni një vizatim që tregon një rast kur keni ndihmuar në shtëpi.

## Një lutje për ndihmë

Ndonjëherë premtojmë se do të ndihmojmë në shtëpi, por kur një shok na kërkon të luajmë, e harrojmë premtimin tonë. Ashtu si Benjamini ndërroi udhë dhe e ndihmoi atin e tij, edhe ne kemi nevojë të ndryshojmë disa nga zakonet tona jo të mira.

Këtu keni një lutje që mund ta mësoni, për t'i kërkuar Perëndisë t'ju ndihmojë të ndryshoni zakonet tuaja jo të mira, në zakone të mira.



*O Krisht, ktheji në rrugën e duhur ata që kanë shkuar në rrugë të gabuar.*

*Bëj që të largohem nga zakonet e këqija te zakonet e mira.*

*Të largohem nga mëkatet e mia dhe të bëj punët që të pëlqejnë.*

*Ki mëshirë për krijesat e tua, veçanërisht për mua.*

### **Fjalë Besimi**

#### **MËSHIRË**

Perëndia tregon mirësi dhe dashuri për ne.

# Një lutje që kërkon mëshirë

*O Zot Jisu Krisht, Biri i Perëndisë, mëshiromë.*

## KËNDI FAMILJAR

Ky mësim është i pari nga katër, të cilët përqendrohen mbi temën e anëtarëve të familjes që bëjnë gjëra së bashku. Prindërit shpesh kërkojnë ndihmën e fëmijëve të tyre ose u japin punëra të vogla, secilit fëmijë për të bërë, si një mënyrë pjesëmarrjeje në punët e familjes.

Madje edhe fëmijët e vegjël janë në gjendje të bëjnë punë të vogla në shtëpi, si fshirja, fshirja e pluhurave, hedhja e plehrave, përkujdesja për kafshët shtëpiake etj. Fëmijët, me siguri, kanë përjetuar edhe gëzimin e zbatimit, ndonjëherë edhe barrën e kërkesës që iu bëhet, kur kanë dashur të luajnë.

Paravolia e dy bijve të **Mateu 21: 28-32**, u jep atyre një tregim me të cilin të identifikohen. Ata mund të identifikohen me reagimet e të dy bijve. Reagimi i birit të parë do t'u paraqesë atyre një model sjelljeje të mirë dhe të pranueshme.

Aktiviteti fton fëmijët të mendojnë për veten e tyre si ndihmës në shtëpi. Përpiquni të zhvilloni te fëmija juaj i vogël zakone të mira këmbënguljeje në punë dhe bashkëpunimi. Duke i dhënë atyre punë, të cilat janë në gjendje t'i bëjnë, zhvilloni në ta një ndjenjë vetëbesimi, e cila do t'i ndihmojë të ndër marrin iniciativa në jetën e tyre dhe të jenë të suksesshëm në atë që bëjnë.

### ***Këtu keni disa aktivitete që sugjerohen për t'u bërë me fëmijën tuaj:***

1. Vëreni fëmijën **të rithotë** apo **dramatizojë** tregimin e dy bijve. Më pas pyeteni se, si cili fëmijë ka qenë më shumë.
2. Në bashkëpunim **bëni** një listë punërash shtëpie, të cilat fëmija mund t'i bëjë dhe vendoseni në mur. Sa herë që fëmija juaj përfundon një punë shënojeni me një x ose me një fytyrë të qeshur. Duke parë tabelën e përbushjeve të punëve, fëmija juaj do të inkurajohet.
3. Mësojini fëmijës tuaj dhe **lutuni** së bashku me lutjet që përmbante mësimi i sotëm:

***O Krisht, ktheji në rrugën e duhur ata që kanë shkuar në rrugë të gabuar.  
Bëj që të largohem nga zakonet e këqija te zakonet e mira.  
Të largohem nga mëkatet e mia dhe të bëj punët që të pëlqejnë.  
Ki mëshirë për krijesat e tua, veçanërisht për mua.***

*O Zot Jisu Krisht, Biri i Perëndisë, mëshiromë.*

## Mësimi 32

# Jisui adhuron së bashku me prindërit e Tij *Ejani të adhurojmë dhe të përkulemi përpara Zotit!*

Bazuar te Psalmi 95:6



### Zbuloni

Të dielën, në mëngjes, këmbanat e kishës bien, duke i thirrur të krishterët të shkojnë në kishë.

Shumë familje vijnë së bashku për të lavdëruar dhe adhuruar Perëndinë.



Bëni një vizatim që tregon kur ju shkoni në kishë së bashku me anëtarë të familjes apo miq.



Lexoni tregimin nga Bibla për të zbuluar se çfarë bëri Jisui së bashku me prindërit e tij.



## Shkrimi i Shenjtë

### Jisui shkon për Pashkë në Jerusalem

Bazuar te Llukai 2:41-52

Çdo vit, Jisui dhe prindërit e Tij zbrisnin në Jerusalem për të festuar Pashkën.

Kur ishte dymbëdhjetë vjeç ata shkuan përsëri. Nga qyteti i Tij, Nazareti, Jisui udhëtonte së bashku me të afërm dhe miq për tri ditë të tëra. Ishte shumë qejf! Thirrje gëzimi mbushnin ajrin, ndërsa miqtë takonin përsëri njëri-tjetrin.

“- Ua, Sara qenka rritur dhe qenka bërë një vajzë e bukur!” – tha një gjyshe.

“- Jisui yt qenka zgjatur dhe qëndroka kaq drejt!” – shtoi një mik.

“- Po, jemi krenarë për të.” – u përgjigj Maria.



Në Jerusalem, Jisui shkoi në tempull për të kremtuar. Në vaktin e Pashkës, ati ofroi një gotë me verë. Jisui i vogël dëgjonte Josifin tek tregonte përsëri sesi e shpëtoi Perëndia popullin e tij nga Egjipti. Kur festa mbaroi, të gjithë përshëndetën njëri-tjetrin dhe thirrën plot gëzim: “- Vitin tjetër sërish në Jerusalem! Takohemi atëherë.”

Gjatë rrugës, kur po ktheheshin në Nazaret, Maria vuri re se Jisui nuk ishte me grupin. Ajo vazhdoi t'i pyeste të gjithë nëse e kishin parë djalin e saj. Askush nuk e kishte parë!

Josifi e ngushëllonte:

“- Mos u mërzit Mari, do të kthehemi në Jerusalem. Mund ta gjejmë atje.”

Me nxitim ata u kthyen në Jerusalem. Zemrat u ishin mbushur me frikë.

Kërkuan për tri ditë dhe e gjetën brenda në tempull duke biseduar me mësuesit.



“- Bir, përse na frikësove kaq shumë!” - i tha Maria. “- Të kemi kërkuar gjithandej.”

“- Përse nënë? Nuk e dini që duhet të qëndrojmë në shtëpinë e Atit tim?”

Mësuesit që kishin biseduar me të ishin shumë të kënaqur. “- Keni një djalë shumë të zgjuar” – u thonin ata prindërve të Tij.

Më pas, Jisui u kthye me Marinë dhe Josifin në Nazaret. Ai vazhdonte të rritej. Jisui u bindej prindërve të tij dhe sillej me shumë respekt ndaj tyre.

Çdo të shtunë, shkonte në sinagogë, së bashku me prindërit dhe njëherë në vit, përsëri në Jerusalem, për festën e Pashkës.





Jeta në Kishë

## Ne adhurojmë së bashku me anëtarët e familjes sonë

Jisui mësoi nga prindërit e Tij, Maria dhe Josifi, të caktonte një kohë të veçantë për të adhuruar Perëndinë. Ata shkonin në sinagogë çdo të shtunë. Një herë në vit, ata shkonin në Jerusalem për Pashkë.

Edhe ne mësojmë nga prindërit dhe gjyshërit tanë, të caktojmë një kohë për të adhuruar Perëndinë. Mëngjesi i së dielës është një kohë e veçantë për adhurim.

Përdorni të dhënat për të zgjidhur enigmën dhe zbuloni sesi e adhurojmë Perëndinë të dielave në mëngjes.

1. shkronja e shtatë te Jerusalem
3. shkronja e parë te tjetër
5. shkronja e tretë te Perëndia
7. shkronja e dytë te Jisui
9. shkronja e gjashtë te prindërit

10. shkronja e tretë te kohë
12. shkronja e gjashtë te adhurojmë
15. shkronja e tretë te verë
16. shkronja e parë te Egjipt

## Ne kremtojmë . . .

	i	u		gj	n				y			n	o	
--	---	---	--	----	---	--	--	--	---	--	--	---	---	--



## **Të krishterët shkojnë në Jerusalem për pelegrinazh**

Kur ne festojmë Pashkën, kujtojmë ditën kur Jisui u ngjall prej së vdekuri. Ne mbushemi me gëzim!

Në Jerusalem, ka një kishë të ndërtuar pikërisht në vendin ku Jisui u ngjall prej së vdekuri. Çdo vit, shumë të krishterë shkojnë te kjo kishë dhe lavdërojnë e adhurojnë Perëndinë për dashurinë e Tij.


Në mesnatë, pasi priftërinjtë dhe njerëzit këndojnë së bashku shumë këngë, episkopi del me një qiri. Drita e qiririt na kujton Jisuin, i cili shkëlqente si drita kur u ngjall prej së vdekuri.

Çdokush ndez qiririn e vet dhe këndon së bashku me priftërinjtë.

## ***Krishti u ngjall së vdekurësh, me vdekje, vdekjen shkeli, edhe të varrosurve jetën u fali !***

Bashkohuni me të gjithë për të lavdëruar Jisu Krishtin.

Vizatoni veten në figurë dhe qiririn tuaj që të shkëlqejë fort në Pashkë.



### **Fjalë Besimi TEMPULLI**

Vendi ku Jisui  
adhuronte së  
bashku me  
prindërit e tij.

# Ne e lavdërojmë Ngjalljen e Jisuit me këngë

## ***Po vjen Pashka***

*Po vjen Pashka, po vjen Pashka  
Lajmëron ajrin me gëzim,  
po vjen Pashka, po vjen Pashka  
pas i shkon dhe shpirti im.*

*Erdhi Pashka, u tha loti  
erdhi Pashka, u ngjall Zoti.*

*Po vjen Pashka, po vjen Pashka  
lulet çelin, gjethet dalin,  
po vjen Pashka, po vjen Pashka  
shpirtin tim me vete marrin.*

*Po vjen Pashka, po vjen Pashka  
dimri i egër s'ka më kthim  
po vjen Pashka, po vjen Pashka  
gjith' natyra thotë: "AMIN"*

## **KËNDI FAMILJAR**

Në këtë mësim, fëmijës suaj iu paraqit përjetimi i anëtarëve të familjes që adhurojnë së bashku. Të shkuarit së bashku me familjen në kishë është përjetimi i çdo fëmije. Të shkuarit në kishë gjatë ditëve të festave, lë gjurmë në kujtimet e fëmijës me ngjarje të rëndësishme, të lidhura me jetën familjare dhe zakonet.

Tregimi për udhëtimin e Jisuit në tempullin e Jerusalemit për të kremtuar festën e Pashkës, së bashku me familjen dhe miqtë, thekson linja të përbashkëta përjetimi, midis Jisuit dhe të tjerëve.

Mësimi e zgjeroi përjetimin e adhurimit të Jisuit së bashku me familjen, deri te përjetimi i fëmijës suaj. Taman, ashtu si Jisui kur ishte fëmijë i vogël, mëson të adhuronte Perëndinë nga prindërit e tij, edhe ata mësojnë të adhurojnë Perëndinë nga prindërit dhe gjyshërit e tyre. Liturgjia Hyjnore të dielën në mëngjes, iu paraqit atyre si një kohë e veçantë adhurimi.

Gjithashtu, përjetimi i pelegrinazhit të djalit Jisu, u lidh me pelegrinazhet e Pashkës në qytetin e shenjtë të Jerusalemit, në kishën e Varrit të shenjtë. Fëmijëve iu mësova të këndonin Troparin e Pashkës.

***Krishti u ngjall së vdekurësh,  
me vdekje, vdekjen shkeli,  
edhe të varrosurve jetën u fali.***

### ***Çfarë mund të bëni si familje:***

1. **Dëgjoni** fëmijën tuaj të thotë tregimin për pelegrinazhin e Jisuit në Jerusalem, së bashku me prindërit e tij.
2. **Shkoni** në kishë çdo të dielë dhe bëhuni pjesë e kremtimit të Liturgjisë Hyjnore.
3. **Mbikqyrni** ditët e festave duke e marrë fëmijën tuaj me vete në kishë.
4. **Këndoni** së bashku me fëmijën tuaj troparin e Pashkës. Praktikojeni në mënyrë që kur të jeni të pranishëm për Liturgjinë Hyjnore të Pashkës, fëmija juaj ta dallojë dhe ta këndojë atë së bashku me të tjerët.

## Mësimi 33

### Jisui dhe nëna e Tij shkojnë në një dasmë *Jisui bëri mrekullinë e Tij të parë në Kana të Galileesë.*

Bazuar te Joani 2:11



#### Zbuloni

Ana po feston ditëlindjen e saj të gjashtë. Prindërit kanë ftuar shoqet dhe shokët e saj në një mbrëmje ditëlindjeje. Shihni figurën dhe bisedoni rreth asaj që po ndodh.



Bëni një vizatim që tregon se si keni vepruar për ta bërë të lumtur shokun tuaj në ditëlindjen e tij.



Në tregimin tonë nga Bibla, zbuloni se çfarë bëri Jisui në festën e dasmës.



## Shkrimi i Shenjtë

### Mrekullia e parë e Jisuit

Bazuar te Joani 2:1-11

Një dasëm do të bëhej në Kana. Miq nga afër e nga larg kishin ardhur për t'i uruar lumturi nuses dhe dhëndrit.

Maria ndodhej atje. Edhe Jisui ishte i ftuar në dasëm, së bashku me dishepujt e vet. Ata u ulën në tryezat festive të mbushura me shumë ushqime dhe pije. Muzika mbushte ajrin dhe të ftuarit kërcenin rreth nuses dhe dhëndrit.

Pak më vonë, një plak pëshpëriti: “- Nuk ka më verë.”

Kur Maria dëgjoji këto fjalë shkoi me shpejtësi të kërkonte ndihmë. Ajo shkoi te Biri i saj dhe i tha: “- Jisu, ata kanë mbetur pa verë.” Jisui vështroi nënën e tij dhe u përgjigj: “- Nënë, çfarë do që të bëj? Koha ime ende nuk ka ardhur!”

Maria kishte besim te Biri i saj. Ajo u tha shërbëtorëve që ndodheshin pranë: “- Bëni gjithçka që ju thotë të bëni.”

Shërbëtorët panë njëri-tjetrin paksa të hutuar.

Ata po qëndronin pranë një dere, ku ndodheshin gjashtë enë të mëdha guri.

Secila enë mund të mbante njëzetë apo tridhjetë galone uji. Jisui u tha atyre: “- Mbushini me ujë enët deri në grykë.”

Shpejt ata bënë ashtu siç u tha. Më pas Jisui tha: “- Tani derdhni pak në një gotë dhe çojani të parit të festës.”



Shërbëtorët nuk mund ta kuptonin, por mbushën gotën. Kur e derdhën ata u çuditën. “- Ky ujë qenka i kuq! Qenka kthyer në verë!”

Ata ia çuan ujin, tashmë të kthyer në verë, të parit të festës. Ai e piu verën. Duke mos e ditur se nga erdhi vera, ai thirri dhëndrin dhe i tha: “- Nuk po kuptoj, çdokush shërben verën e mirë në fillim dhe më pas nxjerr verën që nuk është aq e mirë. Ndërsa ti e paske ruajtur verën më të mirë për në fund!”

Shërbëtorët e dinin me siguri se nga erdhi vera. Kjo ishte mrekullia e parë të cilën Jisui bëri në Kana të Galilesë për të treguar lavdinë e tij dhe dishepujt besuan te ai.



## Fjalë Besimi

### MREKULLI

Jisui bëri shumë gjëra që ishin të pamundura të ndodhnin. Kjo është një shenjë që tregon se Ai është Perëndi.



Mbushni secilën enë me një shkronjë që përputhet me ngjyrën e enës, për të shkruar se ku shkoi Jisui në Kana.

ë

m

s

a



## Jeta në Kishë

### Ne festojmë dasma në kishë

Jisui donte t'ia kalonte mirë me anëtarët e familjes dhe miqtë. Kur ishte në dasmën në Kana, ai tregoi gëzimin e tij për nusen dhe dhëndrin duke festuar së bashku me ta.

A keni qenë në ndonjë dasëm në kishë? Shumë miq vijnë të shohin nusen dhe dhëndrin kur i premtojnë Perëndisë që do ta duan dhe respektojnë njëri-tjetrin. Ja se çfarë ndodh:

Shkruani në rreth numrin e fjalisë që përputhet me secilën figurë.



1. Nusja dhe dhëndri i japin njëri-tjetrit unazat e martesës.

2. Prifti i kërkon Perëndisë t'i bekojë dhe i kurorëzon ata.


3. Nusja dhe dhëndri bëhen mbreti dhe mbretëresha e familjes së tyre të re.



4. Njerëzit qëndrojnë në këmbë në nder të nuses dhe dhëndrit.

5. Nusja dhe dhëndri pijnë verë të bekuar.





## Le të krahasojmë

Jisui në dasmën në Kana

Unë në dasmën



të gëzueshme lutem nënën verë familjen bekoj këndoj

Zgjidhni fjalë nga banka e fjalëve për të plotësuar fjalitë.



1. Jisui shkoi në një dasëm së bashku me



\_\_\_\_\_ dhe dishepujt e tij.


2. Jisui e bëri \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ festën e dasmës. Ai e ktheu ujin

në \_\_\_\_\_.

3. Jisui \_\_\_\_\_ nusen dhe

dhëndrin.



4. Unë shkoj te dasma e tezes/hallës

sime së bashku me \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ dhe të afërmit e mi.

5. Unë \_\_\_\_\_ dhe kërcej

për ta bërë të gëzueshme festën e

dasmës.

6. Unë \_\_\_\_\_ në kishë për

nusen dhe dhëndrin.



## Ne lutemi për nusen dhe dhëndrin

*O Zot, Perëndia ynë që pranove me kujdesin Tënd,  
ta tregosh martesën të cmuar,  
në Kana të Galilesë me ndodhjen tënde,  
Ti tani ruajji me paqe shërbëtorët e Tu.*

### KËNDI FAMILJAR

Mësimi nxori në pah anëtarët e familjes që festojnë së bashku, nëpërmjet tregimit për Virgjëreshën Mari dhe Jisuin që marrin pjesë në dasmën në Kana të Galilesë, gjatë së cilës Krishti ktheu ujin në verë, si mrekullinë e tij të parë.

Mbledhjet dhe festimet familjare janë raste gëzimi dhe fëmijët janë pjesë e tyre. Maria dhe Jisui morën pjesë në gëzimin e miqve të tyre, duke qenë të pranishëm në dasëm. Jisui dha ndihmën e vet në festë, duke e ndryshuar ujin në verë.

Fëmijët identifikuan mënyra me anë të të cilave ata festojnë gëzimet e miqve të tyre apo anëtarëve të familjes dhe u prezantuan me momente të rëndësishme në Misterin e Kurorëzimit. Ata ishin në gjendje të krahasonin pjesëmarrjen e tyre në ceremoninë e martesës, me praninë e Jisuit në dasmën në Kana.

***Këtu keni disa mënyra me të cilat mund të pasuroni përjetimin e fëmijës suaj të festimit me miq dhe anëtarë të familjes:***

1. Kërkoni nga fëmija juaj t'ju **rithotë** tregimin për dasmën në Kana, duke identifikuar njerëzit e rëndësishëm në dasmë. Ju mund ta ndihmoni të luajë si dramë tregimin.
2. **Kujtoni** së bashku me fëmijën tuaj raste ku keni qenë të pranishëm në festime martesash, ditëlindjesh, ditë emri apo pagëzimesh. Identifikoni mënyrën sesi ju si familje ndihmuat që festimi të bëhej një ngjarje e gëzueshme. Kërkojini fëmijës suaj **të vizatojë** një ngjarje të paharrueshme në një nga këto festime.
3. Kërkojini fëmijës suaj **të vizatojë** diçka që të tregojë atë çka ndodh në ceremoninë e dasmës, mbështetur mbi atë që mësuat në këtë mësim. Nëse keni qenë të pranishëm në ndonjë dasmë së bashku me të, thuajini të kujtojë atë ngjarje.



## Mësimi 34

Marta dhe Maria presin Jisuin në shtëpi

***Jisui iu përgjigj: “Martë, ti po shqetësohesh për shumë gjëra, ndërsa Maria zgjodhi pjesën më të mirë.”***

Bazuar te Llukai 10:41-42




### Zbuloni

Kur ishte hera e fundit që patët mysafirë në shtëpinë tuaj? A ju kujtohet ushqimi që hëngrët së bashku? Në këtë kuti vizatoni ushqimet që hëngrët.

Kush e ndihmoi më shumë mamin tuaj për të përgatitur vaktin? Ishit ju apo vëllai a motra juaj? Kush ndihmoi më pak?

Vizatoni fytyrën tuaj për të treguar sesi u ndjetë kur kishit miq në shtëpi.



Në tregimin nga Bibla zbuloni sesi e trajtuan Jisuin motrat.



## Shkrimi i Shenjtë

### Jisui viziton Martën dhe Marinë

Bazuar te Llukai 10:38-42

Jisui udhëtonte shumë çdo ditë. Ai u fliste njerëzve për dashurinë që Perëndia kishte për ta. Ai shëronte të sëmurët, gëzonte të trishtuarit, ushqente ata që kishin uri dhe kalonte kohë me fëmijët.



Një ditë, ai po ecte pranë një fshati të quajtur Betani. Jisui kishte disa miq atje, dy motra, Martën dhe Marinë. Ai shkoi te shtëpia e tyre dhe trokiti në derë. Marta e hapi dhe tha: “- Mirë se erdhët në shtëpinë tonë!” Me nxitim ajo shkoi në oborr dhe thirri motrën e saj: “- Mari, eja, Jisui miku ynë na ka ardhur për vizitë.”

Maria la gjithçka që po bënte dhe erdhi për ta përshëndetur. Tashmë Jisui po rrinte ulur në një divan. Maria u ul në dysheme përballë Jisuit dhe dëgjonte gjithçka që thoshte ai.

Më pas Marta shkoi në kuzhinë. “- Duhet të përgatis për të ngrënë për mikun tonë. Ai duhet të ketë uri” – mendoi ajo. Marta ndezi zjarrin për të pjekur ca mish pule, bëri gati një pjatë me grurë dhe mori frymë thellë: “- Oh, sa shumë janë për t’u bërë. Është pothuajse koha e drekës!” – mendoi ajo. “- Mari, të lutem eja në kuzhinë” – thirri ajo.

Kaluan pesë minuta, më pas dhjetë dhe më pas pesëmbëdhjetë. Maria nuk po vinte. Marta nxitoi te dhoma e ndjenjes. Maria qëndronte atje duke biseduar me Jisuin! “- A nuk i shkon në mend të më ndihmojë?” – mendoi Marta. Ajo i shkoi pranë Jisuit dhe iu ankua: “- Jisu, a nuk do t’ia dish që ime motër ma ka lënë të gjithë punët mua? Të lutem thuaji të më ndihmojë.”



Jisui pa me dashuri Martën dhe tha: “- Marta, Marta, shqetësohesh për shumë gjëra. Përgatitja e ngrënies për mua është diçka e mirë. Por e rëndësishme gjithashtu është edhe të vish e të ulesh këtu me mua dhe të kalojmë kohë së bashku. Maria zgjodhi të kalojë kohë me mua. Përse nuk vjen të qëndrosh edhe ti me ne?”

Zgjidhni fjalët e duhura për të plotësuar fjalitë.



1. Marta e mirëpriti Jisuin dhe \_\_\_\_\_ drekë për të.
2. Maria e mirëpriti Jisuin dhe u ul për ta \_\_\_\_\_ atë.
3. Jisui i kërkoi Martës të vinte e të \_\_\_\_\_ me të.


Jeta në Kishë

## Si i mirëpres mysafirët?


Marta dhe Maria e mirëpritën Jisuin si mysafir. Marta u zu me punët për t'i gatuar ushqim atij. Ajo gjithashtu u zemërua që motra e saj nuk e ndihmoi. Maria u kënaq duke biseduar me Jisuin dhe duke e dëgjuar atë. Mendoni për një rast kur keni patur mysafirë në shtëpi. Si i mirëpritët ata?

Bëni një vizatim në kutinë e Martës, nëse ndihmuat prindërit në mirëpritjen e mysafirëve.

Bëni një vizatim në kutinë e Marisë, nëse jeni kënaqur vetëm duke kaluar kohë duke luajtur dhe biseduar me mysafirët tuaj.



**Marta**



**Maria**

Zgjidhni një figurë e cila tregon sesi do ta mirëprisnit ju Jisuin.



## Ne mirëpresim priftin në shtëpinë tonë

Prifti i enorisë e viziton shtëpinë tonë disa herë gjatë vitit. Ai na viziton për raste të lumtura dhe gjithashtu kur dikush është i sëmurë.

Dy raste të veçanta janë për Krishtlindje dhe Pashkë. Prifti viziton çdo shtëpi për të bekuar anëtarët e familjes dhe shtëpinë ku jetojmë.

1. Nëna përgatit një tabaka të veçantë me një enë me ujë, pak lule borziloku dhe temjan.
2. Prifti ynë vendos një \_\_\_ \_\_\_ \_\_\_ \_\_\_ në tabaka.
3. Ai djeg pak temjam erëmirë.
4. Pas bekimit, secili nga ne puth kryqin dhe pi nga uji i bekuar. Nëna e ruan ujin e bekuar në një shishe të veçantë.



Ngjyrosni të gjitha gjërat që ndodhen në tabaka, të cilat i bekon prifti.

### Fjalë Besimi

#### BUKË MESHE

Bukë që përdoret për Kungatën e Shenjtë.

## Unë mësoj si të përshëndes priftin

Sa herë që shoh një prift apo shkoj në kishë, unë e përshëndes me gëzim. Unë puth dorën e tij të djathtë dhe kryqin që mban në dorë.

Unë them:



“Beko, atë.”

Prifti  
më bekon  
dhe thotë:



“Perëndia të bekoftë.”

## KËNDI FAMILJAR

Mikpritja është një cilësi e dëshirueshme për t'u patur. Përveç ngrënies së bashku si familje, fëmijët përjetojnë gjithashtu dhe ngrënien me miq, në shtëpinë e tyre ose në shtëpinë e miqve të tyre.

Në këtë mësim miqtë e Jisuit Marta dhe Maria presin Jisuin në shtëpinë e tyre (**Llukai 10:38-42**).

Tregimi i bukur për Martën dhe Marinë ka shumë për t'u thënë fëmijëve, që shpesh ankohen se vëllezërit dhe motrat e tyre “nuk bëjnë mjaftueshëm”, për të ndihmuar që të presin miqtë.

Nëpërmjet një aktiviteti që krahasonte mënyrën e mikpritjes së Martës me mënyrën e Marisë, fëmija juaj mësoi që Jisui vlerëson edhe atë që përgatit vaktin dhe atë që kalon kohë me mysafirin.

Për ta zgjeruar më tej rëndësinë e mikpritjes, fëmija juaj u familjarizua me vizitat në shtëpi që bën prifti i enorisë, veçanërisht gjatë Krishtlindjes, Pashkëve dhe Epifanisë, për të bekuar shtëpinë. Në fund, fëmija juaj mësoi mënyrën e duhur të përshëndetjes së një prifti.

***Këtu keni disa mënyra nëpërmjet të cilave mund t'u përforconi mikpritjen e krishterë fëmijëve tuaj:***

1. Ndërsa **prisni** mysafirë në shtëpi, ftojini fëmijët tuaj të marrin pjesë në pritjen e tyre, duke i përshëndetur si duhet dhe duke kaluar kohë me ta, veçanërisht kur janë edhe fëmijë të pranishëm.
2. **Ftoni** priftin e enorisë të vizitojë shtëpinë tuaj dhe kujdesuni që fëmijët të jenë të pranishëm.
3. **Inkurajoni** fëmijën tuaj të ftojë shokë për të luajtur dhe nxitni zakone të mira mikpritjeje, të tilla si ndarja e lodrave, të luajturit miqësisht etj.
4. Sa herë që takoni një prift, inkurajojeni fëmijën tuaj **ta përshëndesë** siç duhet, ashtu si paraqitet në këtë mësim.

# Familja e Perëndisë kremton

Familja e kishës kremton shumë festa.  
Në pranverë, ne kremtojmë Festën e Ngjalljes  
së Jisu Krishtit, dhe dyzetë ditë më vonë  
Festën e Ngjitjes në qiell të Zotit tonë.



# Familja e Perëndisë kremton



## *Për prindërit*

Mësimet mbi Festën e Ngjalljes dhe Festën e Ngjitjes në qiell të Jisu Krishtit, e futin fëmijën në mënyrën sesi i kremton kisha këto dy festa. Festa e Ngjalljes është themeli i besimit të krishterë dhe Festa e Ngjitjes në qiell është afirmimi i premtimit të Perëndisë, që Jisui do të vijë përsëri, të marrë me vete në qiell të gjithë ata që besojnë.



Mësimi 35

## Festa e Ngjalljes së Jisu Krishtit

### *Unë pashë Zotin!*

Bazuar te Joani 20:18





Zbuloni

Nëna me dy fëmijët e saj po përgatit vezët e Pashkës. A keni lyer ju vetë ndonjëherë vezë Pashke? Çfarë përdorët për t'i ngjyrosur ato?



Ngjyrosni këto vezë Pashke. Përquni t'i bëni sa më të bukura të mundeni.



Në tregimin nga Bibla zbuloni se çfarë kremtojmë në Ditën e Pashkës.



## Shkrimi i Shenjtë

### Gratë te varri i Jisuit

Bazuar te Llukai 7:36-8:3; 23:44-24:12; Mateu 28:1-10, Marku 16:1-8, Joani 20:11-18

Lexoni së bashku me mësuesin tuaj tregimin dhe më pas ngjyrosni figurën.



Ndërsa shkonte nga fshati në qytet, duke mësuar dhe duke treguar për Perëndinë, disa njerëz e shoqëronin Jisuin. Ishin edhe disa gra që i shkonin pas Jisuit. Disa e ndihmonin Jisuin nga shtëpitë e tyre dhe të tjera udhëtonin së bashku me të, ndërsa predikonte.

Atje ishte Maria, nëna e Tij, Saloma dhe Maria, nëna e Jakovit, Joana, Suzana, dhe disa të tjera që e ndihmonin Jisuin, por nuk ua dimë të gjithave emrat.

Maria Magdalena i shkonte pas gjithashtu. Jisui e kishte ndihmuar shumë atë duke e çliruar nga gjërat e këqija. Jisui ishte miku më i mirë i saj.

Një të premtë në Jerusalem, Maria dhe gratë e tjera e vështronin Jisuin, ndërsa ai kryqëzohej dhe vdiste. Gratë ecnin dhe qanin me trishtim, ndërsa shkonin për të përgatitur erërat.

Të dielën, pikërisht para agimit, gratë shkuan te varri për të lyer trupin e Jisuit me aroma erë mirë.

Ato pyetën njëra-tjetrën: “- Si do ta rrokullisim atë gur të rëndë, në mënyrë që të hyjmë te varri?” Papritmas vendi ku ndodheshin u trondit. Gratë u tmerruan. Një dritë e shkëlqyeshme mbushi vendin ku po qëndronin. Një engjell i veshur në të bardha u duk pranë varrit.

Engjëlli tha: “- Mos kini frikë. Po kërkonte Jisuin që u kryqëzua? Ai nuk ndodhet këtu. Ejani dhe shihni vendin ku ishte shtrirë. Ai është kthyer përsëri në jetë! Shkoni në Galile dhe thujuni dishepujve se ai do t’ju takojë atje.”

Gratë ikën nga varri të frikësuara, por edhe me gëzim të madh. Papritur një njeri i takoi dhe u tha:


“- Përshëndetje!”

Maria mendoi se ishte kopshtari dhe e pyeti: “- Zotëri, a e dini se ku e kanë çuar trupin e Zotit tim, Jisuit?” Ai njeri u përgjigj: “- Mari!”


Pikërisht në atë moment Maria e kuptoi në zemrën e saj që ai ishte Jisui. Ajo i ra ndër këmbë dhe thirri: “- Mësuesi im!”

Jisui u përgjigj: “- Mari, shko dhe thujuni dishepujve të mi që unë jam ngjallur. Unë jetoj.”

Maria vrapoi sa më shpejt që mundte dhe shkoi në dhomën ku ishin mbledhur të gjithë dishepujt. Ajo thirri me gëzim: “- Pashë Zotin! Ai jeton!”



PASHË ZOTIN! AI JETON!



Jeta në Kishë

## Themi me zë të lartë: "Krishti u ngjall!"



Pashka po afrohej dhe atmosfera e saj ndjehej kudo nëpër shtëpi. Elena me padurim po priste të shtunën kur do të lyente vezët e kuqe bashkë gjyshen e saj, Sofian.

Ndërsa e shtuna erdhi dhe mamaja kishte filluar përgatitjet e festës, Elena shkoi në kuzhinë të ndihmonte këtë vit gjyshen për të lyer vezët. Duke pritur të merrnin ngjyrë vezët, gjyshja filloi t'i tregonte një histori

Elenës. Ajo i tregonte shpesh herë mbesës së saj histori shumë të bukura! “- Kur isha në moshën tënde, ne e kremtonim shumë bukur festën e Pashkës. Më vonë, filluan disa vite të errëta, kur shteti i mbylli të gjitha kishat dhe ne nuk mund të shkonim më në Kishë që të luteshim. Edhe në shtëpi nuk mund të mbanim ikona nëpër mure, sepse ishte një gjë e ndaluar. Mbaj mend se në mur kishim hapur një vend dhe kishim futur të gjitha ikonat e shtëpisë. Kështu, natën para Pashkës, e nxirrnim një ikonë nga muri dhe ndiznim para saj një kandil të vogël. Në këtë mënyrë ne mund të luteshim në fshehtësi.”

“- Po vezë të kuqe, si sot, a mund të lyenit gjyshe?” - pyeti me kureshtje Elena.

“- Ah, e dashur Elenë. Si çdo gjë tjetër që bëhej në fshehtësi, edhe lyerja e vezëve bëhej në këtë mënyrë. Përpara se të filloja të lyeja vezët, unë sigurohesha që i kisha mbyllur perdet mirë, në mënyrë që të mos na shihte njeri nga jashtë.

Kështu e festonin ngjalljen e Jisu Krishtit të gjithë të krishterët e Shqipërisë në ato vite. Megjithëse ishin mbyllur Kishat, megjithëse nuk mbanim ikona, nuk uronim me zë të lartë “Krishti u ngjall!”, përsëri besimi ynë tek Zoti Jisu Krisht i ngjallur ishte shumë i madh. Ne besonim se Jisui së shpejti do ta ringjallte edhe Kishën e Shqipërisë. Besimi ynë ishte shumë i madh. Dhe ja ku jemi sot, duke thënë sërish me zë të lartë “Krishti u ngjall!”

### Fjalë Besimi

**KRISHTI U NGJALL**

**VËRTET U NGJALL**

Përshëndetja e  
Pashkës

## Ne vazhdojmë t'i tregojmë botës

Më kujtohet, kur isha katër vjeç, mamaja dhe babai më çuan në kishë për Pashkë, kur ishte errësirë dhe natë. Mund të dëgjoja korin që këndonte: “Krishti u ngjall!” Kur u zgjova në prehërin e babait tim ishte mëngjesi i Pashkës.

Nga kisha, ne shkuam në shtëpi. Mëngjesi ishte i veçantë atë ditë, na prisnin vezët e kuqe të Pashkës. Mësova se ne bëjmë disa gjëra të veçanta ditën e Pashkës. Shihni figurat për të zbuluar se cilat janë ato. Vendosni një ✓ në kutinë pranë fjalive që përshkruajnë figurat.

Shkoj në shkollë.

Luaj lojën e thyerjes së vezëve.



Vizitoj fqinjët dhe miqtë duke u thënë: “Krishti u ngjall”.

Marr vezë të ngjyera Pashke nga fqinjët.

Ha bukë të ëmbël Pashke.

Rregulloj dhomën time.



# Ne këndojmë gëzimin tonë të Pashkës

*Krishti u ngjall së vdekurësh,  
me vdekje, vdekjen shkeli,  
edhe të varrosurve jetën u fali!*

## KËNDI FAMILJAR

Festa e Ngjalljes së Zotit tonë është një përjetim i cili është i njohur për fëmijët, nëpërmjet kremtimeve në kishë dhe në shtëpi. Praktikata e ndryshme që kryhen në këtë ditë feste janë të ngulitura në mendjen e fëmijëve.

Tregimi nga Shkrimi i Shenjtë për Ngjalljen që u paraqit në këtë mësim mbështetur te **Llukai 7:36-8:3; 23:44-24:12; Mateu 28:1-10, Marku 16:1-8, Joani 20:11-18**, u siguroi fëmijëve fakte konkrete që nënvizojnë kremtimet festive të kësaj feste.

Ky tregim dhe paraqitjet për disa zakone të shoqëruara me kremtimin e Festës së Ngjalljes, kanë si qëllim pasurimin e besimit të fëmijës te Zoti ynë i ngjallur.

Tregimi për origjinën e vezëve të Pashkës dhe lojërave që lidhen me to, zakoni i vizitës te të afërm dhe miq për t'i përshëndetur ata me përshëndetjen e Pashkës, të gjitha këto i ftojnë fëmijët të marrin pjesë në shpalljen, e cila së pari u bë nga Maria Magdalena kur u tha dishepujve: "Pashë Zotin! Ai jeton!"

### ***Këtu keni disa gjëra që mund të bëni me fëmijët:***

1. Kërkojini fëmijës suaj të bëjë një **vizatim** të tregimit që dëgjuan në klasë.
2. Vëreni fëmijën tuaj **të luajë si dramë** tregimin e Maria Magdalenës për vezën e kuqe të Pashkës.
3. Të Enjten dhe të Shtunën e Madhe **ngjyeni** vezët e Pashkës së bashku me fëmijët tuaj.
4. Shoqërojeni fëmijën tuaj kur **viziton** fqinj të dielën e Pashkës, për t'i përshëndetur ata duke thënë: "Krishti u ngjall!"

Mwsimi 36

## Festa e Ngjitjes në qiell

***Ndërsa Jisui po i bekonte ata, Ai u mor lart në qiell.***

Bazuar te Llukai 24:51



Zbuloni

Stërgjyshi i Kostës erdhi për ta vizituar atë. Ai qëndroi me familjen e tij për shumë muaj. Më pas erdhi koha që stërgjyshi të kthehej në shtëpi. Kur u largua, Kosta nuk mund ta shihte më atë. Por ai e dinte që stërgjyshi ishte kthyer në shtëpinë e tij.



Si mendoni, për çfarë po shpreson Kosta? Zgjidhni fjalët e duhura për të plotësuar fjalinë.

flejë    vijë përsëri    luajë me top

***Stërgjyshi do të*** \_\_\_\_\_

Në tregimin nga Bibla vini re se kush u kthye në qiell, por që do të vijë përsëri.



## Shkrimi i Shenjtë

### Jisui kthehet te Ati i tij

Bazuar te Llukai 24:36-53; Mateu 28:18-20; Veprat e Apostujve 1:1-11

Lexoni tregimin së bashku me mësuesin tuaj. Përdorni fjalët nga banka e fjalëve dhe shkruajini në vendet e duhura.



Jisui u ngjall ditën \_\_\_\_\_. Ai nuk ishte më i vdekur, por erdhi në jetë. Shumë nga miqtë e tij e pritën me gëzim lajmin, por disa nuk besuan.

“- A vdiq vërtetë Jisui?” - pyesnin ata. “- A \_\_\_\_\_ me të vërtetë?” Ishin disa që e donin të vdekur Jisuin.

Kështu që ata shpikën gënjeshtër të liga.

Zoti ynë donte që të gjithë ta mësonin të vërtetën. Kështu që ai qëndroi në tokë për \_\_\_\_\_ ditë, për t’u treguar që ishte

ngjallur me të vërtetë. Ai udhëtoi, bisedoi dhe hëngri së bashku me ta. Jisui u tregoi atyre plagët në duar dhe brinjë. Madje Thomain e la t’i prekte plagët.

**Banka e Fjalëve  
e Pashkës  
u ngjall  
dyzetë**



Së bashku me dishepujt e tij, Jisui eci derisa arritën te një mal atje pranë. Ai u ul dhe foli me ta: “- Gjithë pushteti në qiell dhe në tokë është i imi. Ju jeni lajmëtarët e mi”, – tha Ai.

“- Shkoni dhe ndani me të gjithë dashurinë që kam treguar për ju. I bëni të gjithë \_\_\_\_\_, mësojuni gjithçka që ju kam mësuar.

\_\_\_\_\_ata në emrin e Atit, Birit dhe Shpirtit të Shenjtë. Shkoni dhe rini në Jerusalem derisa të dërgoj Shpirtin e Shenjtë. Sapo të vijë Shpirti i Shenjtë, do të mësoni se çfarë duhet të bëni. Kujtoni, do të jem me ju gjithë ditët e jetës suaj.

Jisui ngriti duart dhe i bekoi. Ndërsa po i bekonte, para syve të tyre, Jisui filloi të shkëputej nga toka dhe të ngrihej në qiell. Miqtë e Tij kërcenin dhe thërrisnin fort! Ata vazhduan ta shihnin, derisa Zoti u fsheh nga një re. Ata vazhduan të shihnin drejt qiellit, kur papritur dëgjuan dikë të fliste.

Dy njerëz me rroba të bardha që shkëlqenin qëndruan pranë tyre dhe thanë: “- Pse po shihni lart? Jisui që u mor në qiell, por \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ në të njëjtën mënyrë. Dhe atëherë

do të marrë të gjithë ata që besojnë në qiell, për të ndenjur bashkë me Të.”

Zemrat e tyre u mbushën me gëzim.

Duke lavdëruar Perëndinë ata u kthyen në Jerusalem, për të pritur Shpirtin e Shenjtë.



**Banka e Fjalëve**

**dishepuj**

**pagëzojini**

**do të vijë**

Jeta në Kishë

## Apostujt zgjedhin

Bazuar te Veprat e Apostujve 1:15-26

Pasi Jisui u mor në qiell, dishepujt u kthyen në Jerusalem dhe shkuan në dhomën ku kishin ngrënë Darkën e Fundit me Jisuin.


Sa njerëz shihni ulur në figurë? \_\_\_\_

Apostull Pjetri u ngrit dhe u tha pasuesve të Jisuit: “- Miq, Juda ishte anëtar i grupit tonë. Por ai doli kundër Jisuit, kur ndihmoi ata që e arrestuan. Tani ai nuk është më me ne. Le të zgjedhim dikë për të zënë vendin e tij.”

Ata sollën dy njerëz që e donin Jisuin dhe e kishin pasuar kur ishte në tokë. Të dy ishin njerëz të mirë, prandaj nuk dinin kë të zgjidhnin.

Kështu që u lutën: “- Zot, Ti e njuh mirë çdo njeri. Na trego se cilin nga këta të dy ke zgjedhur për të zënë vendin e Judës.”

Më pas hodhën short për ta dhe shorti i ra Matias.



### Fjalë Besimi

#### HEDHJE SHORTI

Zgjedhje nga  
dy gjëra.

Matia u bë apostulli numër \_\_\_\_.

## Ne besojmë

Kisha jonë beson atë që engjëjt u thanë apostujve kur Jisui u mor në qiell. Çdo të dielë kur themi Simbolin e Besimit, ne themi atë që besojmë.

Shkruani fjalët në vendet e duhura për të zbuluar se çfarë themi.




Jisui do të \_\_\_\_\_ përsëri me të njëjtin \_\_\_\_\_

1

2

Bëni një vizatim për të treguar sesi, sipas mendimit tuaj, do të duket Jisui kur të vijë përsëri.



## Ne këndojmë me gëzim

U ngjite në qiell me lavdi, o Krisht Perëndi dhe Zot,  
dhe i gëzove dishepujt duke u premtuar  
Shpirtin e Shenjtë që lartazi.  
Dhe me bekimin që morën u siguruan,  
se Ti je i Biri i Perëndisë, dhe Shpëtimtari i botës.

### KËNDI FAMILJAR

Festa e Ngjitjes në Qiell e Zotit tonë Jisu Krisht kremtohet dyzetë ditë pas Festës së Ngjalljes.

Ngjarja e Krishtit që merret në qiell në një re është një tregim mrekullues për fëmijët gjashtëvjeçarë dhe siguron mundësinë për t'u mësuar atyre atë që pohojmë në Besore: “Dhe u ngjit në qiell, dhe rri në të djathtë të Atit. Dhe do të vijë përsëri me lavdi, për të gjykuar të gjallët dhe të vdekurit, mbretëria e të cilit nuk do të ketë mbarim.”

Ajo që pasoi Ngjitjen e Zotit ishte zgjedhja e bërë për të zëvendësuar Juda Iskariotin, ashtu si përshkruhet te **Veprat e Apostujve 1:15-26**.

#### ***Ndihmojeni fëmijën tuaj të kremtojë Festën e Ngjitjes në Qiell:***

1. Kërkojini fëmijës suaj **të rithotë** tregimin e Ngjitjes në Qiell dhe të bëjë një vizatim të tij.
2. Në një shirit letre shkruani: “Jisui do të vijë përsëri.” dhe vëreni fëmijën tuaj **ta ilustrojë** atë. Vendoseni shiritin në një mur të dukshëm në shtëpi në Festën e Ngjitjes në Qiell.
3. **Këndoni** së bashku himnin e Ngjitjes në Qiell.

## **Lutje për fëmijët**

### **1. SHENJA E KRYQIT**

Në emër të Atit, të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë. Amin.

### **2. LAVDËRIMI I TRINISË SË SHENJTË**

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

### **3. LUTJA E ZOTIT**

Ati ynë që je në qiejt,  
u shenjtëroftë emri yt,  
ardhtë mbretëria jote,  
u bëftë dëshira jote,  
si në qiell ashtu dhe mbi dhé.  
Bukën tonë të përditshme,  
jepna neve sot.  
Dhe falna fajet tona,  
sikurse dhe ne ua falim fajtorëve tanë.  
Dhe mos na shtjer në ngasje,  
po shpëtona nga i ligu. Amin.

## **5. LUTJE E MËNGJESIT**

O Zot, hap buzët e mia, dhe goja ime do të shpallë  
lavdërimin tënd. *Psalmi 50:15*

- 6.** Zot Jisu, të falënderoj për dhuratën e kësaj dite të re. Kur erdhe në tokë për ne, u rrite si fëmijë në urtësi dhe hir. Si Zot, more fëmijët në krahët e Tu. I bekove dhe u the se mbretëria jote u përket atyre. I dashur Jisu, prit më dhe mua këtë ditë dhe dëgjo lutjen time të mëngjesit. Beko prindërit e mi, mësuesit dhe të gjithë ata që më duan dhe kujdesen për mua.

## **7. LUTJE PARA NJË DETYRE**

O Zot Jisu Krisht, Perëndia ynë, Ti the: “Larg meje ju nuk mund të bëni asgjë”. Me besim, o Zot përqafoj fjalët e tua dhe i lutem mirësisë sate. Ndhimomë të çoj deri në fund punën që po filloj dhe ta përfundoj atë. Se ty ta drejtoj lavdinë, Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë. Amin.

## **8. LUTJE PAS NJË DETYRE**

Të falënderoj, o Zot, që më dhe fuqi dhe më udhëhoqe në punët e mia. Ti je përmbushja e gjithë të mirave. Mbush dhe shpirtin tim me gëzim e kënaqësi që të të lavdëroj përjetë. Amin.

## **9. LUTJE PËRPARA SE TË FLEMË**

Zoti ynë Jisu, Ti prite fëmijët që erdhën tek Ty. Na prit edhe ne, fëmijët e Tu dhe dëgjo lutjen tonë të mbrëmjes. Na mbro nën strehën e krahëve të Tu, që të mund të flemë në paqe dhe të ngrihemi në mëngjes që të lavdërojmë Ty, Zotin tonë të dashur. Amin.

## **10. LUTJE PËR PRINDËRIT**

Zot dhe Shpëtimtar, Ty, që na ke mësuar të nderojmë etërit dhe nënat tona dhe të tregojmë dashuri dhe bindje ndaj tyre. Po të lutem nga thellësitë e zemrës sime, o Jisu i ëmbël, Perëndia im: dëgjoma lutjen. Beko prindërit që më kanë rritur me ndihmën e hirit Tënd. Mbroji nga çdo rrezik, sëmundje apo e keqe. Dhuroju besim, shëndet dhe gëzim. Beko çdo punë të tyre që ata të mund të të japin nder dhe lavdi për gjithë ditët e jetës. Amin.

## **11. LUTJE PËR SHENJTORIN PËRKATËS**

Shën (emri i shenjtorit) luto për mua.

